



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-16842/24
Kaçanik, 18.07.2024

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VII (shtatë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 26.07.2024 (e Premte), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e VII (shtatë) të Rregullt të KPF-s të datës 26.07.2024, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2024;
3. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2023;
4. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2023.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-14085/24
Kaçanik, 24.06.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI (gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24.06 2024, në ora 11:00. Për shkak të kushteve teknike, mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në Zyrën e Kryetarit të komunës.

Përbërja e KPF është prej 6 anëtarëve, nga 7 anëtarë sa është përbërja e përgjithshme, deri me zëvendësimin e anëtares Fitore Vishi, e cila ka dhënë dorëheqje nga Kuvendi i Komunës, për shkak të punësimit në Shërbimin Civil, me çka me automatizëm i kanë pushuar pozitën e ndërlidhura me KK, si çështja e pozitës së anëtares në KPF.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 5 anëtarë: Kemal Murseli, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni Ardita Rrahmani, Rabiye Sallahi. Në mbledhje mungoj pa arsye, Kadri Krivenjeva.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Pranvera Loku-Zharku-DZHET.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu- ZLP për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të KPF-a për vitin 2024, data 24 qershor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2025-2027;
3. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024;
4. Propozim Vendim për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024;
5. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 06-350-9402/2016 të datës 30.03.2016 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ZK në Kaçanik të Vjetër, për ndërtimin e Impiantit, për trajtimin e ujërave të zeza;
6. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite;
7. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, të pronës së paluajtshme të komunës;
8. Propozim Vendim për realizimin e një vizite zyrtare studimore e anëtarëve të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të komunës Kaçanik, jashtë vendit - në një nga vendet e rajonit;
9. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 60/01-38152/21 të datës 29.12.2021 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

10. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 08-320/01-11894/24 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e breshërit në territorin e komunës së Kaçanikut, në Llanishtë dhe Kotlinë;
11. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11398/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Doganaj, ofertuesit ROYAL BENVERAGE LLC;
12. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC;
13. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha;
14. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11403/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Kotlinë, ofertuesit ECO-EXCLUSIV Sh.P.K.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 14 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar u aprovua pa vërejtje, me 4 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj, Kadrije Lika-Troni, për shkak se nuk ka qenë pjesë e procesit. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 27.05.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-11539/24.

2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2025-2027;

Kryesuesi i Kuvendit: I potencoj aktivitetet e zhvilluar për KBAK, me theks të veçantë, diskutimin publik i organizuar nga kryesuesi në konsultim me KPF. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: E njoftoj KPF se Lista e Investimeve kapitale ka pësuar ndryshime. Për mbledhje të KK ua dërgojmë vetëm 2 fletat që kanë të bëjnë me Investimet kapitale. KBAK mund të pësoj edhe ndryshime tjera deri sa të bëhet buxheti final.

z. Agim Mani: KBAK gjatë rrugës së aktiviteteve, mund të pësoj ndryshime, pastaj edhe ne realizim, se bëhen rialokime, tranfere. Po me intereson të buxheti aktual, është rritur për 1 milion e 200 mijë euro, ku janë ngritjet?

z. Bahri Selimi: Janë diku 1 milion 198 mijë euro. Mjetet janë nga GQ janë 607 mijë e 55 euro, afër 5.5%, ndërkaq HVK janë 26%. Në vazhdim drejtori sqaroj sa është përqindja e përgjithshme e ngritjes se buxhetit.

z. Agim Mani: Me këtë ngritje, a rriten Investimet kapitale, se dihet se këto mjete me tepër shkojnë në Paga dhe Mëditje.

z. Bahri Selimi: Me këtë ngritje rriten edhe Investimet kapitale, por nuk e dimë saktë sa. Qarkorja e dytë buxhetore e definon saktë vlerën sesa shkojnë për paga dhe mëditje, 633,250 euro janë shpërndarë në secilën kategori. Pagat diferencë është 187 mijë, 92 mijë euro, Mallrat dhe shërbimet, 5 mijë Shërbimet komunale, 98 mijë euro janë Subvencionet dhe transferet, 130,000 mijë Investimet kapitale.

znj. Ardita Rrahmani: Po flitet se nga shtatori rritet koeficienti i pagave. Nëse rritet koeficienti i pagave, çka ndodhë me neve, se kjo ngritje është ngarkesë për komunën?

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ndodhë para miratimit të buxhetit, ngritjet hynë në buxhet, ndërkaq pas miratimit të buxhetit, atëherë shkohet me rishikim buxhetor. Të arsimi dhe shëndetësia, ato kanë grantin specifik dhe ngritjet mund të jenë nga grantet.

z. Bahri Selimi: Nëse rritet koeficienti i pagave, besoj se rritet buxheti i komunës. Vendimi është qeveritar dhe ata e bëjnë një buxhet shtesë. Niveli qendror si ta shoh të arsyeshme, pasi është vit zgjedhor, munden me përcaktuar me qarkoren e tretë buxhetore.

znj. Ardita Rrahmani: Lë të jetë si kritikë, që kur të bëhen organizimet nga ne-KPF, secili nga ne të paktën të jemi pjesëmarrës, sepse paguhemi, që të paktën para qytetarëve të arsyetohemi dhe kur të bëjnë kritikën të jemi të koordinuar aty. Nuk po bëjë politikë, por nga ana njerëzore, secili nga ne duhet të jemi të pranishëm, se paguhemi për këtë punë. Kritika tjetër është për kushte pune të mbajtjes së mbledhjeve tjera të KPF, se këtu nuk ka kushte, kështu që për hera tjera të mbahen mbledhjet në një vend me të përshtatshëm.

Kryesuesi i Kuvendit: Për çështjen e kushteve teknike, pati vërejtje edhe në KK, nuk e di kush merret me këtë punë.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Mesazhin e KK ia kam përcjellë drejtores se Administratës. Edhe kjo mbledhje ka me vazhduar kështu, për shkak të punimeve që janë duke u punuar tualetet se barten pluhuri, pavarësisht se e bëjmë pastrimin e sallës.

Kryesuesi i Kuvendit: Organizimi i debatit publik konsultim me KPF për KBAK ka ndodhë për herë të parë. Ftesat janë dërguar me kohë, besoj se diskutimi për buxhetin do të jetë më mirë i organizuar.

z. Agim Mani: Për diskutimin publik për KBAK, është me rëndësi qytetarët me marrë pjesë, së ne si KPF e kemi vendin ku diskutojmë. Mos realizimi i kërkesave gjatë debatit me qytetarë, qytetari është i zhgënjyer dhe nuk merr pjesë në debate. Qytetari formalisht merr pjesë në debate publike, ndërkaq Ekzekutivi duhet gjetur formën e realizimit të kërkesave.

znj. Ardita Rrahmani: Në diskutim publik, ka pasur kërkesa specifike, që ne nuk i kemi ditur. Është mirë me marrë pjesë në diskutim publik, me i dëgjuar kërkesat e qytetarëve dhe me ditur se a janë përfshirë ato kërkesa në buxhet.

Nënkryetari i Komunës: Ne nuk mund t'i sjellim qytetarët në debat kundër vullnetit të tyre. Është dëshirë e tyre për me marrë pjesë në diskutim publik, se nuk mundemi me dirigjuar askënd. Mospjesëmarrja e qytetarëve në debate publike, po ndodhë për faktin se, qytetarët po e gjënë derën e hapur të Zyra e Kryetarit për me i shprehur brengat dhe shqetësimet e tyre. Ne me buxhetin që e kemi, po mundohemi me i realizuar kërkesat e qytetarëve.

znj. Rabiye Sallahi: Arsyeja e mospjesëmarrjes së qytetarëve në debate publike, drejtor mund të jetë, koha jo e duhur me mbajtur debatit në orën e caktuar 11 të ditës, se qytetarët janë nëpër puna. Tjetra, qytetarët mund të mos kenë njohuri të mjaftueshme se çka është KBAK.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja e debateve publike, nuk është vetëm e komunës tonë, gjithkund është problem. Problemi është se komunat nuk kanë shumë qytetari aktive. Ne kemi takuar grupe të interesit, qytetarët duhet kërkesat e tyre me i adresuar në debate publike. Kërkesat që vijnë të kryetari janë me shumë individuale, ndërsa kur janë kërkesat e komuniteteve, grupeve, atëherë duhet me u ngritur në debate publike. E përmendi edhe Ardita që ka kërkesa që ne nuk kemi njohuri, as kryetari mundet mos me jetë në dijeni, por në debat publik vjen qytetari dhe e paraqet shqetësimin. Mirë është me marrë pjesë në debate publike, me i shprehur shqetësimet, ne kemi mbajtur debat publik edhe në restorant, por pjesëmarrja e qytetarëve nuk ka qenë e kënaqshme. Diskutime të tjera nuk ka, KBAK u shtrua në votim me i kaluar KK dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2025-2027. Ky dokument i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim dhe në procedurë të mëtutjeshme.

3. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Në mungesë të rishkimit buxhetor, po bëhen lëvizje të mjeteve brenda vitit, për një shpenzim me të mirë buxhetor. Mjetet po i rialokojmë të parkingu nëntokësor, kemi filluar do takime me ministrinë e kulturës, pritët diçka me u zhvilluar, janë 278,430€ që hiqen, mjete shkojnë brenda DAP. 190 mijë shkojnë për rregullimin e sistemit të ngrohjes qendrore të objekti të administratës komunale dhe 88, 430€ shkojnë për blerjen e veturave për nevojat të administratës. Me rishikim buxhetor, i dërgon këto mjete kudo, ndërkaq me transfere me kaluar në KK dhe në MF është vetëm 15% e projektit. Me dashur me shumë mund të shkojmë 25%, por për këtë vendosë Kuvendi i Kosovës dhe kjo po na merr shumë kohë. Në vazhdim drejtori sqaroj edhe mjetet që rialokohen të urbanizmi dhe ku destinohen.

z. Agim Mani: Projekti ndërtimi i urave mbi lumin Neredime dhe Lepenc, shuma 90,000 €, a është kryer ky projekt?

z. Bahri Selimi: Jo nuk është kryer ende, për këtë arsye kemi arritur me urën Nikaj-Biçec, sivjet përfundon kjo, ndërsa në Nikaj në vitin vijues. Nëse nuk na dalin mjetet, atëherë duhet me një aneks kontratë. 90% e punëve të urës janë kryer.

Nënkryetari i Komunës: Paratë kanë qenë pak për ndërtimin e urës mbi lumin Neredime, kanë qenë vlerë me e vogël, tani janë rritur çmimet, kanë hyrë në tender me shtrenjtë, sesa shuma e planifikuar. Dy herë ka dështuar tenderi, drejtori është munduar me hequr një pjesë që me zvogëluar projektin, mos me na humbur mjetet, se është dashur me marrë veprime të nevojshme, për mos me humbë projektin.

znj. Ardita Rrahmani: Të çështja e ndërtimit të urave mbi Neredime e Lepenc, është mirë me intervenuar, se është njëfarë hendeku aty. Deri në vjeshtë janë një 3-4 muaj, verës ka qarkullim, me të mëdha të njerëzve, fëmijëve, kështu që është mirë me intervenuar në atë pjesë, në mënyrë që mos me u rrezikuar fëmijët, se ata nuk i dinë pengesat që janë aty.

z. Agim Mani: Sa mjete janë ndarë për ndërtimin e urave mbi lumin Neredime dhe Lepenc dhe a janë zotuar mjetet? Nëse janë zotuar mjetet, çfarë logjike ka me shtuar ende mjete?

z. Bahri Selimi: Për ndërtimin e urave i kemi ndarë 132,744€ janë momentalisht në buxhet për këto ura. Për mos me shkuar mjetet në suficit, i kemi paraparë këto mjete me shkuar në asfaltimin e rrugëve lokale dhe rurale, nga 45,000€. Mjetet janë zotuar. Kërkesa ka të shumta për rrugë urbane e rurale, si Stagovë, Kaçanik të Vjetër, veç a i kemi mjetet, se me i pasur edhe 500 mijë euro, nevojë ka për rrugë, qoftë urbane apo rurale. Ne duhet me paraparë mjetet, se Zyra e prokurimit nuk mundet me nisur procedura pa i pasur mjetet, kështu që ne duhet me i nisur procedurat me herët, mos me na ngel mjetet në suficit. Procedurat besoj se nisen diku në gusht-shtator, pjesa e dytë e projektit, me kontratë të re. Momentalisht ne kemi kontratë për rrugë lokale dhe rurale, çështja është vetëm a kemi buxhet të ai kod dhe me mbushë me mjete.

z. Agim Mani: Të ndërtimi i urës mbi lumin Neredime dhe mbi Hekurudhë, po i merrni edhe 5,000€.

z. Bahri Selimi: Të mjetet nga projekti, Ndërtimi i urës mbi lumin Neredime dhe mbi Hekurudhë, shuma 5,000€ shkojnë për projektin, Ndërtimin e shtretërve të përroskave. Nuk po kemi proces të rregullt të rishikimit buxhetor, se me pasur rishikim buxhetor, mundemi me shtuar edhe projekte të reja. Ne nuk guxojmë me lënë buxhet nën vlerën e kontratës, kontrata është, 40,000€.

z. Agim Mani: Me mirë është me paraparë shumë mjete për një projekt, sesa vetëm me koduar. Kur të hartohet buxheti, është mirë planifikimi me qenë i qëndrueshëm mbi 90%. Operatorit duhet me ia përcjellë punët në terren. Duhet me qenë serioz për projektet e koduara, me ndarë më shumë mjete, jo vetëm me koduar projektin sa për me qenë në listë. Duhet me pasur bashkëpunim me memorandume të ministrive, ministria nuk bashkë financohet në kodin buxhetor të projektit, ajo e krijon kodin e ri buxhetor.

z. Bahri Selimi: Janë duke ndryshuar rrethanat, çmimet po janë të shtrenjta, operatorët nuk po hynë me çmime të lira, se është rritë kostoja e derivateve, materialit ndërtimor etj., kështu që nuk kanë faj. Duhet me pasur me pak projekte, me tepër mjete, se nuk ka më projekte me 20-30 mijë euro. Rruga ‘Idriz Seferi’ ta marrim shembull, ka kod në veti në ministri, kod në veti të ne, projekti është i njëjtë. Tani po thonë: lëni mjetet për bashkëfinancim, çka të ndodhë, ato mjete i procedon aty, kjo ka bërë që ne do mjete po i heqim nga kodi buxhetor. Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit, të një kod bashkë financohen shumë projekte.

Nënkryetari i Komunës: Është mirë me pasur me pak projekte me kode buxhetore, por çështja është së, janë do projekte që nuk i lëmë pa koduar, si çështja “Ndërtimi i SHF “Emin Duraku”, Ndërtimit të fabrikës së ujit etj.

Kryesuesi i Kuvendit: Planifikimi është mbi 90%, por çështja është e shumës 10%, se është bukur e madhe. Duhet me pasur projekte me pak, me nda mjete me shumë, se janë rritur çmimet, kompanitë nuk mundem me hyrë me çmime të lira. Sa me shumë projekte e kode buxhetore, janë ngarkesë edhe për drejtorinë. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendim për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Sqaroj për mjetet nga nën programi, Ndërtimi i nën parkingut nëntokësor të Administratës komunale, shuma 51,570€. Këto mjete transferohen, shuma 8,000€ në projektin, Ndërtimi i kanalit të ujitjes në f. Biçec, 16,850€ në projektin, Ndërtimi dhe funksionalizimi i objektit për banim social, shuma 10,420€ në projektin: Planifikimi urban dhe inspeksioni.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqë nuk u paraqit kush për diskutim, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 06-350-9402/2016 të datës 30.03.2016 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ZK në Kaçanik të Vjetër, për ndërtimin e Impiantit, për trajtimin e ujërave të zeza;

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi është marrë në vitin 2016, tani janë ndryshuar apo shtuar parcelat, që po ndryshohet vendimi. Drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Qamil Stagova: Sqaroj për ndryshimet të cilat bëhen në vendim. Është bërë studimi i fizibilitetit, ka pasur bashkim të parcelave, ndërkaq një parcelë është e re që është shtuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Është projekt shumë i rëndësishëm, mjetet ka marrë obligim me i paguar komuna e Ferizajt. A i paguan komuna e Ferizajt shpronësimet, nuk e di a është ende ajo marrëveshje?

z. Qamil Stagova: Po, shpronësimet i paguan komuna e Ferizajt, disa prona duhet me i dërguar në vlerësim në ministri.

z. Agim Mani: Janë bërë 8 vite nga marrja e vendimit për shpronësimin e pronave për impiant. Pronat private kanë kaluar në prona shoqërore, ndërkaq pronarëve të atyre pronave iu ka bërë një e padrejtë se nuk kanë mundur me i shfrytëzuar ato prona.

Kryesuesi i Kuvendit: Është marrë vendim, se është menduar me përfshirë krejt Ferizajn. Në bazë të rrjedhjes qysh e kërkon kanalizimi, me dalë në pronat e komunës së Kaçanikut. Ne jemi pajtuar në vitin 2016 për pronat, ndërkaq kompensimin me e bërë komuna e Ferizajt. Atyre pastaj iu ka dështuar projekti për ndërtim të impiantit dhe nuk e kanë kryer obligimet për shpronësim dhe kanë mbet si vendim në fuqi deri në ekzekutim. Tani po aktivizohet përsëri, sigurisht për 8 vjet ka pasur bashkim të parcelave, se pronat janë ende private se nuk ka kaluar pronësia të komuna pa u paguar.

z. Qamil Stagova: Vendimi nuk është ekzekutuar, parcelat kanë ndryshuar se disa janë ndarë, disa janë bashkuar, ato prona nuk janë shpronësuar ende.

Kryesuesi i Kuvendit: Derisa ato prona nuk janë paguar, pronarët kanë pasur të drejtë me i shfrytëzuar, se pronat nuk i kanë kaluar komunës në pronësi.

z. Agim Mani: Vlerësimin e pronave e bënë MF. Me intereson të di, a shtohet ndonjë parcelë me këtë Propozim Vendim?

znj. Kadrije Lika-Troni: Për derisa vendimi ka qenë në fuqi, si ka pasur mundësi me u shtuar parcela tjera për impiantin?

z. Qamil Stagova: Po, shtohet vetëm një parcelë, ndërkaq nga parcelat që janë lejuar me u shpronësuar me vendim të vitit 2016, ka nga parcelat që është bërë bashkimi i tyre.

Nënkryetari i Komunës: Sqaroj për parcelat për impiant, kemi pasur një takim para dy javësh me kryeshefin e kompanisë, me 3 drejtori të Ferizajt dhe të komunës tonë. Ka ndryshime se janë bërë bashkim apo ndarje të parcelave, ekipi ka bërë studim të fizibilitetit dhe për rrugën. Ekipi e ka kryer punën e vet, tani kërkohet me u bërë ndryshim plotësimi i vendimit. Uroj të mos dështoj ky projekt, ndërkaq theksoj se kanë me pasur kyçe në kanalizim disa fshatra, Doganaj, Duraj, Elezaj etj. Ne si komunë e kemi marrë seriozisht këtë çështje dhe i kemi kryer punët tona të cilat na përkasin

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 06-350-9402/2016 të datës 30.03.2016 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ZK në Kaçanik të Vjetër, për ndërtimin e Impiantit, për trajtimin e ujërave të zeza. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite;

Kryesuesi i Kuvendit: I dini procedurat, fillimisht duhet të merret vendimi Paraprak, pastaj me u zhvilluar procedurat tjera. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Parcelat e propozuara, a janë në listë për me u dhënë në shfrytëzim në vitin 2024?

Kryesuesi i Kuvendit: Po, parcelat e propozuara janë në listë me u dhënë në shfrytëzim. Shumica e parcelave janë kullosë, mal, me PZHK të ri duhet të përshtatën këto prona, se me siguri nuk është tokë ndërtimore aty.

z. Qamil Stagova: Nuk është tokë ndërtimore, ne kemi disa kërkesa për investime për veprimtari bujqësore, kemi menduar me kombinuar veprimtarinë bujqësore, deri sa të bëhet me PZHK.

z. Agim Mani: Këto prona me shpallje publike, a mundet me ndryshuar komplet destinimin, me u bërë ndonjë zonë ndërtimore, se janë në kundërshtim me PZHK. Nëse PZHK e ka përcaktuar tokë bujqësore, faji i mbetet komisionit vlerësues. Komisioni vlerësues nuk po merret me këtë çështje, po merret vetëm me procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, ekzekutivi duhet me i pasur parasysh këto çështje. Është mirë të theksohet se për çdo parcelë të pronat bujqësore, lejohet dhënia në shfrytëzim e tyre për investime në bujqësi. Nëse veprohet në këtë mënyrë, atëherë edhe ofertat vinë për investime në bujqësi.

z. Qamil Stagova: Nëse ka të interesuar për veprimtari tjera me investuar, atëherë atyre pronave duhet me ua ndërruar destinimin

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja është se mundet me dal problem me ndërrimin e destinimit të pronave. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, të pronës së paluajtshme të komunës. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

8. Propozim Vendim për realizimin e një vizite zyrtare studimore e anëtarëve të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të komunës Kaçanik, jashtë vendit - në një nga vendet e rajonit;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo vizitë është e paraparë edhe në planin e punës së KK. Kam menduar vizita me u realizuar në Turqi, jam në kontakt edhe me disa komuna të vendeve tjera. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Në vitet tjera kur është marrë vendim për realizimin e vizitave zyrtare, Propozim Vendimi ka qenë vetëm për anëtarë të KK, tani është edhe për anëtarë të Ekzekutivit.

Kryesuesi i Kuvendit: Ashtu është, por praktika e ka treguar se vizitat zyrtare pa Ekzekutivin e komunës janë të zbehta.

z. Bahri Selimi: Vizitat zyrtare në komunat me specifika të njëjta, përfiton shumë komuna, por çështja është me u realizuar ditëve të punës, për me pa sesi lëshohet një dokument.

znj. Ardita Rrahmani: Ka komuna që kanë kryetar me prejardhje shqiptare. Unë njoh dikë nga lidhjet shoqërore në ambasadën e Turqisë, kështu që mundem me i pyetur.

Kryesuesi i Kuvendit: Kushdo që ka dikën, dhe mundet me vendosur kontakt, nuk ka problem. Ne mundemi me shqyrtuar mundësinë që edhe agjendën me e kryer kompania. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për realizimin e një vizite zyrtare studimore e anëtarëve të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të komunës Kaçanik, jashtë vendit - në një nga vendet e rajonit. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

9. Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 60/01-38152/21 të datës 29.12.2021 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është çështje formale, ka pasur mundësi mos me ardhur fare në KK. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 60/01-38152/21 të datës 29.12.2021 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa. Ky Propozim Vendim i Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

10. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 08-320/01-11894/24 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e breshërit në territorin e komunës së Kaçanikut, në Llanishtë dhe Kotlinë;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, një vendim të kësaj natyre e kemi pasur edhe me herët, E hapi diskutimin:

z. Suhad Dullovi: Kemi pasur edhe një rast me herët për f. Biçec që është vendosur. Ministria ende nuk e ka bërë ekzekutimin e vendimeve as të atyre të vitit 2022.

z. Agim Mani: Mjetet a janë barrë e komunës apo e ministrisë?

z. Suhad Dullovi: Mjetet janë barrë e ministrisë, është Agjencia e cila vendosë për mjetet në bazë të vlerësimit të komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit: Komisioni nuk ka dal nga KK që me i raportuar KK. Komisioni është i drejtorisë dhe i raporton drejtorisë. Unë mendoj se nuk është kjo çështje në kompetenca të KK dhe nuk ka logjikë me vendosë KK.

z. Agim Mani: Çka nëse nuk realizohet ky vendim?

znj. Pranvera Loku-Zharku: Çështja është se komuna e ka bërë vlerësimin e dëmit. Ministria nuk e njih drejtorinë e bujqësisë, ministria e njih institucionin komunal.

z. Suhad Dullovi: Kjo çështje është në kompetencë të KK sipas ligjit. Unë e gjej ligjin dhe ua dërgoj sqarimin në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 08-320/01-11894/24 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e breshërit në territorin e komunës së Kaçanikut, në Llanishtë dhe Kotlinë. Ky Propozim Vendim i Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

11. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11398/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Doganaj, ofertuesit ROYAL BENVERAGE LL.C;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, urdhëroni:

znj. Ardita Rrahmani: A është dashur me u zëvendësuar Adnan Reka, i cili ka ofruar dorëheqje nga komisioni vlerësues?

Kryesuesi i Kuvendit: Lënda ka qenë në proces kur Adnani ka ofruar dorëheqje. Për lëndët tjera formohet komisioni i ri vlerësues. Adnani ka ofruar dorëheqje, zëvendësimi bëhet në KK, Adnani ka qenë anëtar valid deri me aprovimin e dorëheqjes. Çështja është se ne nuk mundemi me kthyer komisionin në zero.

z. Qamil Stagova: Kur ka ofruar dorëheqje Adnani, lëndët kanë qenë gati, është prituri procedura e ankesave. Për lëndët tjera, formohet komisioni tjetër vlerësues.

z. Agim Mani: Për biznesin që e zhvillon kjo kompani, hapësira e rekomanduar është shumë e madhe, gati 3 ha.

Kryesuesi i Kuvendit: Prona është në zonë ekonomike, pronarët janë të “Arsi Cola”, ujin e marrin nga Shtërpca.

z. Qamil Stagova: Pronat që jepen në shfrytëzim janë të shënuara në rekomandim, kompania është serioze, është fjala për kompaninë “Arsi Cola”.

znj. Pranvera Loku-Zharku: Kompania është gjigant i madh, kjo kompani është serioze dhe është nder që ka ardhur me investuar në komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, të gjithë janë të pajtimit që ky rekomandim t’i përcjellët KK. Në bazë të kësaj del konstatohet se KPF

Njoftohet

Me Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11398/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Doganaj, ofertuesit ROYAL BENVERAGE LLC. Rekomandimi i komisionit vlerësues i përcjellët KK për shqyrtim dhe miratim.

12. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, urdhëroni:

z. Agim Mani: A iu lejohet qasja në rrugë të kjo pronë, pronarëve të tokave përreth?

z. Qamil Stagova: Prona ka qenë e komunës, e kanë shfrytëzuar qysh iu ka ardhur me lehtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, të gjithë janë të pajtimit që ky rekomandim t’i përcjellët KK. Në bazë të kësaj del konstatohet se KPF

Njoftohet

Me Rekomandimin e komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC. Rekomandimi i komisionit vlerësues i përcjellët KK për shqyrtim dhe miratim.

13. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky e ka stallën. Nëse ka kush diçka, urdhëroni:

z. Agim Mani: A e ka stallën e vet?

Kryesuesi i Kuvendit: Po, stallën e vet e ka. Diskutime të tjera nuk ka, të gjithë janë të pajtimit që ky rekomandim t'i përcjellët KK. Në bazë të kësaj del konstatohet se KPF

Njoftohet

Me Rekomandimin e komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha. Rekomandimi i komisionit vlerësues i përcjellët KK për shqyrtim dhe miratim.

14. Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11403/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Kotlinë, ofertuesit ECO-EXCLUSIV Sh.P.K;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo kompani merret me agro turizëm. Nëse ka kush diçka, urdhëroni:

znj. Pranvera Loku-Zharku: Po kjo kompani merret me agro turizëm, është në gjigand i madh, unë kam qenë në kompaninë e tij në Gjilan dhe është nder që kjo kompani vjen me investuar të ne.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, të gjithë janë të pajtimit që ky rekomandim të shkoj në KK. Në bazë të kësaj del konstatohet se KPF

Njoftohet

Me Rekomandimin e komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11403/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Kotlinë, ofertuesit ECO-EXCLUSIV Sh.P.K. Rekomandimi i komisionit vlerësues i përcjellët KK për shqyrtim dhe miratim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:37. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët sa ishin prezentë - 05. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 28.06.2024, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



I	Data	16.07.2024	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01-060/01-16666/24				



Republika e Kosovës

Komuna e Kaçaniku

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Opština Kacanik - Municipal Kaçanik

RAPORTI GJASHTË MUJOR FINANCIAR

Per periudhën: Janar – Qershor

2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Për Kuvendin
Komunal

Kryetari i komunës :

Besim Ilazi



Kaçanik, Korrik – 2024

I. Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Qershor 2024:

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Qershor 2024 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë. Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesëve do të prezantohet për 12 (dymbëdhjetë) programet buxhetore:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata e Përgjithshme dhe Çështjet Gjinore,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxhet dhe Financa,
5. Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm,
6. Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencat,
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
8. Planifikimi Urban dhe Mjedisi,
9. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
10. Arsim,
11. Kulturë, Rini dhe Sport,
12. Zyra Lokale për Komunitete.

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2024

TABELA 1: IMPLEMENTIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2024

TË HYRAT BUXHETORE		Buxheti i miratuar 2024	Buxheti i tanishëm 2024	Shpenzimet 31.06-2024	Shpenzimet 31.06-2023	Progresi në %	Krahasimi 2024/23 në €	Indeksi 2024/2023 (%)
		1	2	3	4	5=3/2	6=3-4	7=3/4
A	TOTAL FINANCIMI QEVERITAR	11,034,783.00	11,034,783.00	4,415,999.06	4,050,376.65	40.02	365,622.41	9.03
1	GRANTI I PËRGJITHSHËM	5,130,643.00	5,130,643.00	1,463,362.36	1,310,428.64	28.52	152,933.72	11.67
2	GRANTI I ARSIMIT	4,395,331.00	4,395,331.00	2,326,365.08	2,107,916.68	52.93	218,448.40	10.36
3	GRANTI I SHËNDETËSISË	1,508,809.00	1,508,809.00	626,271.62	632,031.33	41.51	(5,759.71)	(0.91)
B	TOTAL TË HYRAT VETANAKE-PARTICIPIMET DHE DONACIONET	924,200.00	1,792,057.42	98,501.70	-	5.50	98,501.70	#DIV/0!
4	TË HYRAT VETANAKE 2024	924,200.00	924,200.00	1,007.70	-	0.11	1,007.70	#DIV/0!
5	TË HYRAT E BARTURA NGA VITI PARAPRAK	-	867,857.42	97,494.00	-	-	97,494.00	-
6	BARTJET E FONDEVE TË VITIT PARAPRAK: DONATORËT, PARTICIPIMET	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI (A+B)		11,958,983.00	12,826,840.42	4,514,500.76	4,050,376.65	35.20	464,124.11	11.46

-Buxheti i miratuar i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2024, është caktuar sipas Qarkores Buxhetore nr.2024/01 me kufijtë buxhetor fillestar në shumë prej: **11,958,983.00€**.

-Mjetet pjesërisht të bartura nga vitet paraprake të cilat i janë shtuar buxhetit aktual janë në shumë prej 867,857.42 euro. Kështu shuma e buxhetit të tanishëm ka arritur në **12,826,840.42 euro**.

- Burimet e financimit të Buxhetit Komunal vijnë nga:

1. Granti i përgjithshëm 5,130,643.00 €
2. Granti specifik i arsimit: 4,395,331.00 €
3. Granti specifik për shëndetësi: 1,508,809.00 € dhe
4. Të hyrat vetanake: 924,200.00 €

Struktura e përbërjes së buxhetit sipas burimeve të financimit duket kështu:

Grantet Qeveritare: 11,034,783.00 € apo 92.27 % e buxhetit total,
HVK – Projeksionet : 924,200.00 € apo 7.73 % e buxhetit total.

-Shpenzimi total per periudhen Janar – Qershorë 2024 është në shumë prej 4,514,500.76€ apo 35.20% e planifikimit vjetorë 2024.

II. Raporti i inkasimit të të hyrave vetanake:

Të hyrat vetanake **direkte** të grumbulluara gjatë periudhës raportuese kanë arritur lartësinë e realizimit prej **351,713.65€** që përbëjnë **38.06%** të planifikimit të gjithëmbarshtëm vjetorë në shumë prej **924,200.00€**. Këto të hyra për periudhën Janar-Qershor 2024 janë krijuar sipas burimeve të identifikuara nga të gjitha Drejtoritë bazuar në planifikimet vjetore.

- Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave janë grumbulluar gjithsej: **193,450.36€** apo **55%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit janë grumbulluar gjithsej mjete në shumë prej: **82,337.91€** apo **23.41%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Shuma tjetër e grumbullimit të mjeteve, është realizuar nga këto pesë (6) programe apo drejtori: Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shuma prej: **9,689.82€**, Administratës së Përgjithshme, shuma prej: **9,873.00€**, Arsimit **23,814.00€**, Drejtoria e Bujqësisë, Plltarisë dhe Zhvillimit Rural, shuma prej: **15,266.86€**, Drejtoria e Shërbimeve Publike, shuma prej: **11,951.70€** dhe Zyra e Inspektoriatit shuma prej **5,330.00€** që së bashku përbëjnë **21.59%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Krahasuar me inkasimin e realizuar të vitit 2023 të së njëjtës periudhë, nga raporti i realizimit të HVK-së të vitit 2024 del se janë inkasuar mjete prej: **171,486.67.00 €** më pak se në vitin 2023 nga të hyrat direkte.
- *Rënia në grumbullimin e të hyrave vetanake në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, fillimisht ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në Ligjin e Tatimit në pronë, ku sipas ligjit të ri është rritur vlera e zbritjes për secilin tatimpagues për pronën e cilësuar për **banim primarë** nga 15,000.00€ në 30,000.00€, ndryshimet tjera sipas UA nga Qeveria siq është heqja e kushtëzimeve administrative me rastin e regjistrimit të veturave, ndryshimeve tjera kadastrale si psh.shitë-blerja e pronave private nga tatimpaguesve borgjlinjë në tatim prone, poashtu edhe rënia nga taksat për leje ndërtimore të Drejtorisë e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinorë dhe Mjedisit.*

Të hyrat indirekte të cilat realizohen nga Gjykatat, Policia dhe Agjensioni Pyjor i Kosovës nuk na janë dërguar ende. Këto të hyra megjë realizohen nga këto institucione tjera, nuk përfshihen në planifikim por vetëm si realizim sepse edhe shpenzimi i tyre i takon komunave.

- Ndërsa tabela në vijim paraqet në mënyrë të përgjithshme realizimin e hvk-së për periudhën raportuese, krahasimin e realizimit me drejtorive dhe viteve:

Emertimi i të hyrave vetanake	Planifikimi Janar-Dhjetor 2024	Realizimi: Janar Qershor 2024	Plani/Realizimi vjetorë (në %)	Realizimi: Janar-Qershor 2023	Krahasimi 2024/2023
Tatimi në pronë	391,545.00	132,009.30	33.71	218,066.81	(86,057.51)
Tatimi në tokë	80,543.00	24,647.06	30.60	57,681.01	(33,033.95)
Taksa nga rexhistrimi i automjeteve	70,000.00	35,270.00	50.39	31,395.00	3,875.00
Taksa nga ushtrimi i veprimtarisë	3,000.00	-	-	2,380.00	(2,380.00)
Taksa tjera	1,000.00	1,524.00	152.40	211.10	1,312.90
Total: Buxhet dhe Financa	546,088.00	193,450.36	35.42	309,733.92	(116,283.56)
Taksa komunale për leje ndërtimi	190,000.00	20,000.55	10.53	105,350.44	(85,349.89)
Taksa për regjistrimin e trashigimisë	2,000.00	-	-	848.92	(848.92)
Taksa tjera Administrative	1,000.00	29,562.29	2,956.23	24,458.00	5,104.29
Taksa për çerifikata të pronësisë dhe kopje plani	15,000.00	4,233.00	28.22	5,266.00	
Taksa për leje mjedisore	12,000.00	1,620.90	13.51	10,403.92	
Taksa për legalizimin e objekteve	10,000.00	7,595.77	-	5,618.46	
Shfrytëzimi i pronës publike	16,812.00	11,186.40	66.54	3,653.46	7,532.94
Taksa për matjen e tokës në teren	7,000.00	8,139.00	116.27	5,388.00	2,751.00
Total: Urbanizmi & Kadastri	253,812.00	82,337.91	32.44	160,987.20	(70,810.58)
Shfrytëzimi publik për tregti të hapur (reklamati)	1,600.00	1,471.20	91.95	2,432.60	(961.40)
Taksa për parking publik	10,000.00	10,480.50	104.81	-	
Taksa tjera Administrative	100.00	-	-	177.50	(177.50)
Total: Shërbimet Publike dhe Emergjencia	11,700.00	11,951.70	102.15	2,610.10	(1,138.90)
Taksa e Ndërrimit Destinimit të Tokës	20,000.00	13,750.89	68.75	11,079.50	2,671.39
Taksa për Shfrytëz. e Resurseve nat.	2,000.00	-	-	1,165.10	(1,165.10)
Taksa tjera	2,000.00	1,515.97	75.80	620.00	895.97
Total: Bujqësia dhe Pyltaria	24,000.00	15,266.86	63.61	12,864.60	2,402.26
Taksa e çertifikatave të lindjes	15,000.00	7,975.00	53.17	732.00	7,243.00
Taksa e çertifikatave të kurorëzimit	5,000.00	1,046.00	20.92	1,063.00	(17.00)
Taksa e çertifikatave të vdekjes	1,000.00	227.00	22.70	182.00	45.00
Taksa e çertifikatave tjera ofiqare	5,000.00	-	-	8,596.00	(8,596.00)
Taksa tjera Administrative	1,000.00	625.00	62.50	61.00	564.00
Total: Administrata e Përgjithëshme	27,000.00	9,873.00	36.57	10,634.00	(761.00)
Gjobat nga inspektorati	5,000.00	5,330.00	106.60	2,765.00	2,565.00
Inspektimi higjeniko-sanitarë	200.00	-	-		-
Inspektimi i respektimit të planit Urb.	200.00	-	-		-
Licencat pranim tekn. lokalit	200.00	-	-		-
Total: Të hyrat nga Inspektoriati	5,600.00	5,330.00		2,765.00	2,565.00
Taksa për çertifikata mjekësore	10,000.00	4,755.00	47.55	4,986.00	(231.00)
Participimet në shëndetësi	10,000.00	4,934.82	49.35	10.00	4,924.82
Total: Shëndetësia dhe M.S.	20,000.00	9,689.82	48.45	4,996.00	4,693.82
Participimet	36,000.00	23,814.00	66.15	18,609.50	5,204.50
Total: Arsimi dhe Kultura	36,000.00	23,814.00	66.15	18,609.50	5,204.50
GJITHSEJ TË HYRAT DIREKTE	924,200.00	351,713.65	38.06	523,200.32	(171,486.67)

III . Shpenzimet e realizuara për periudhën Janar – Qershor 2024:

Dinamika e shpenzimeve për këtë periudhë është realizuar me **35.22 %** në raport me Buxhetin aktual apo shuma prej **4,514,500.76€** ndërsa krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shkallën e shpenzimit prej **11.46%** më shumë apo shumën prej: **464,124.11€**.

KATEGORITE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE (KESH)		Buxheti aktual 2024	Shpenzimet e realizuara 31.06-2024	Shpenzimet e realizuara 31.06-2023	Progresi përball plan. buxhetor	Krahasimi: Buxheti - Shpenzimet	Krahasimi 2024 / 2023 në €	Krahasimi 2024/2023 në %
		1	2	3	4=2/1	5=1-2	6=2-3	7=2/3
1	Pagat dhe medijtjet	6,749,178.84	3,327,945.37	3,016,222.88	49.31	3,421,233.47	311,722.49	10.33
2	Mallrat dhe shërbimet	1,430,806.00	461,858.35	383,459.21	32.28	968,947.65	78,399.14	20.45
3	Shpenzimet komunale	252,245.64	84,277.12	44,850.70	33.41	167,968.52	39,426.42	87.91
4	Subvencionet dhe transferet	465,331.00	133,948.00	114,479.80	28.79	331,383.00	19,468.20	17.01
5	Shpenzimet kapitale	3,894,277.21	506,471.92	491,364.06	13.01	3,387,805.29	15,107.86	3.07
6	Rezerva komunale	25,000.00	-	-	-	25,000.00	-	#DIV/0!
TOTALI (1 deri 6)		12,816,838.69	4,514,500.76	4,050,376.65	35.22	8,302,337.93	464,124.11	11.46

Tabela e planifikimit të ndarjeve buxhetore sipas Drejtorive apo Programeve Buxhetore për vitin 2024:

SEKTORI - DREJTORIA:	PAGA DHE MEDITJE	MALLRA DHE SHERBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	INVESTIME KAPITALE	TOTALI
ZYRA E KRYETARIT	247,733.53	20,000.00	-	60,000.00	-	327,733.53
ADMINISTRATA E PERGJITHSHME & Q.Gjinore	154,956.21	85,000.00	15,000.00	-	412,000.00	666,956.21
KUVENDI KOMUNAL	221,755.26	5,000.00	-	-	-	226,755.26
ZHVILLIMI EKONOMIK	23,954.42	5,000.00	-	40,000.00	335,000.00	403,954.42
BUXHETIMI - FINANCAT	80,601.27	10,000.00	-	-	250,000.00	340,601.27
SH.PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMERGJENCA	245,600.91	310,000.00	80,000.00	60,000.00	496,313.00	1,191,913.91
ZYRA E KOMUNITETEVE	10,439.86	1,000.00	-	-	-	11,439.86
BUJQESIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL	104,111.60	10,000.00	-	100,000.00	50,000.00	264,111.60
URBANIZMI - PLANIFIKIMI URBAN	116,206.76	65,000.00	-	-	1,012,279.00	1,193,485.76
AD.SHËND. DHE SHERBIMET SOCIALE	88,225.95	5,000.00	5,000.00	10,000.00	5,000.00	113,225.95
SHERBIMET SHENDETESORE PRIMARE	1,138,296.07	290,513.00	50,000.00	-	50,000.00	1,528,809.07
KULTURA, RINIA, SPORTET	131,628.93	130,000.00	15,000.00	70,000.00	135,000.00	481,628.93
ARSIMI DHE SHKENCA	4,208,367.24	385,000.00	50,000.00	50,000.00	515,000.00	5,208,367.24
TOTAL BUXHETI:	6,771,878.00	1,321,513.00	215,000.00	390,000.00	3,260,592.00	11,958,983.00

Tabela në vijim paraqet shpenzimin sipas Programeve Buxhetore dhe atë sipas K.Ekonomike Janar-Qershor 2024:

NR	PROGRAMET BUXHETORE (11)	Stafi i lejuar	Pagat dhe mëditje	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Totali	Struktura në % sipas (PB)
1	Zyra e kryetarit	27	122,729.82	22,504.41	-	25,700.00		170,934.23	3.79
2	Administrata e pergjithshme	25	79,558.72	40,917.44	10,106.08			130,582.24	2.89
3	Zyra e kuvendit komunal	23	111,858.48	550.80				112,409.28	2.49
4	Financat, Buxheti	11	33,149.47	-				33,149.47	0.73
5	Zhvillimi Ekonomik, Turizmi	3	10,858.74	456.90			91,634.25	102,949.89	
6	Sherbimet publike dhe emergjenca	28	149,889.88	221,732.42	38,380.16	14,175.00	197,713.87	621,891.33	13.78
7	ZLK	1	5,445.39	-				5,445.39	-
8	Bujqesia, Pylltaria dhe ZHR	15	22,065.55	1,539.91				23,605.46	0.52
9	Kultura, Rinia dhe Sportet	18	56,230.54	27,683.29	9,283.21	58,450.00	33,524.12	185,171.16	
10	Planifikim urban dhe mjedisi	13	50,599.41	10,688.36			114,437.84	175,725.61	3.89
	ADMINISTRATA KOMUNALE	164	642,386.00	326,074	57,769	98,325	437,310	1,273,743.01	28.21
11	Shendetesia dhe mireqenia soc.	130	542,963.86	67,299.01	10,195.11	1,500.00	4,313.64	626,271.62	13.87
12	Arsimi	535	2,142,595.51	68,485.81	16,312.56	34,123.00	64,848.20	2,326,365.08	51.53
	TOTALI (1 deri 11)	829	3,327,945.37	461,858.35	84,277.12	133,948.00	506,471.92	4,514,500.76	100.00
	Struktura ne % sipas (KESH)		73.72	10.23	1.87	2.97	11.22	100.00	

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE NË MALLËRA DHE SHËRBIME															Sipas gjendjes më 30.06.2024	
KESH	MALLËRAT DHE SHËRBIMET	Zyra e Kryetarit	Zyra e Kuvendit	Zhvillimi Ekonomik	Administrata e Përgjithshme	Financat	Sherbimet Publike	Bujqësia, Pylkaria e ZHR	Urbanizmi dhe Kadastr	Kultura	Arsimi	Shëndetësi dhe MS	Totali TM2/2024	Struktura - në %	TM2 2023	Dallimi në EURO
		7,350											7,350	2	171	7,179
13140	UDHËTIMET ZYRTARE JASHT VENDIT								50				50	0	460	(410)
13310	SHPENZIMET E INTERNETIT												2,735	1	2,305	-
13360	SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE				2,735								25	0	4,029	(4,004)
13330	SHPENZIMET POSTARE				25							2,791	2,791	1	1,430	-
13430	SHËRBIMET E NDRYSHME SHËNDETËSORE									1,900			11,750	3	1,970	9,780
13440	SHËRBIMET KESHILLDHËNËSE DHE PROFESIONALE	1,383			8,467							7,000	7,000	1	5,731	259
13445	SHËRBIMET-KONSULENT DHE KONTRAKTOR INDIVIDUAL						100			1,000	990		5,990	5	85,986	(64,254)
13470	SHPENZIMET E SHËRBIMEVE TEKNIKE	3,900		70					457		21,276		21,732		-	35,942
13460	SHPENZIMET E SHËRBIMEVE KONTRAKTUESE				8,766					14,026	2,192	10,958	35,942	1	4,000	1,011
13475	SIGURIMI FIZIK I OBJEJTEVE												5,011	1	-	3,460
13480	SHPENZIMET PËR ANËTARSIM	5,011										3,460	3,460	1	-	3,776
13501	MOBILJË (më pak se 1000 euro)												-	-	3,776	(3,776)
13556	SHPENZIMET E PAISJES SPECIALE MJEKËSORE												7,504	2	9,381	(1,877)
13610	SHPENZIMET E FURNIZIMIT PËR ZYRË	1,085			1,896		166		1,063	1,120	2,175		10,099	2	9,627	472
13620	SHPENZIMET E FURNIZIMIT ME USHQIM E PUE		90		1,164					16	8,373	455	21,283	5	9,336	11,947
13630	SHPENZIMET E FURNIZIMEVE MJEKËSORE						102			1,753	5,397		7,451	2	1,660	5,791
13640	FURNIZIMET E PASTRIMIT				200					6,561			6,561	1	-	6,561
13720	SHPENZIMET E NAFTËS PËR NGROHJE				319						24,946		25,265	5	26,598	(1,333)
13760	DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE				6,188		1,712	1,080		130	600	7,925	17,635	4	23,790	(6,155)
13780	DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATOR, MAKINERI												-	-	500	(500)
13810	Paraja e imët (Pety Cash)									940	303	338	1,956	0	2,081	(125)
13950	REGJISTRIMI & SIGURIMI I AUTOMJETEVE	374								142		2,336	5,568	1	8,906	(3,338)
14010	MIRËMBAJTJA E RIPARIMI I AUTOMJETEVE	105			1,788		778	419				1,229	1,229	0	10,755	(9,526)
14020	MIRËMBAJTJA E RIPARIMI I NDËRTESAVE											2,006	2,006	0	2,740	(734)
14023	MIRËMBAJTJA E SHKOLLAVE												179,798	39	148,667	31,131
14032	MIRËMBAJTJA E RRUGËVE LOKALE								9,497				32,580	1	2,659	29,921
14060	MIRËMBAJTJA RUTINORE											6,824	6,824	1	8,398	(1,574)
14050	MIRËMBAJTJA E MOBILJEVE DHE PAISJES				238							89	327	1	1,971	(1,644)
14130	QERAJA PËR PAISJE-MIRËMBAJTJA E TI	2,157	461	387	1,740				41	78	95	141	4,713	1	681	4,032
14310	SHPENZIMET E PËRFAQESIMIT BRENDA VENDIT	1,139			7,390		15,994						27,223	6	5,321	21,902
14410	SHPENZIMET E VENDIMEVE TË GJYKATAV															
	TOTALI I SHPENZIMEVE :	22,504	551	457	40,917	-	221,732	1,540	11,145	27,683	68,486	67,299	461,858	100	383,460	78,398
	Struktura e pjesëmarrjes	4.87	0.12	0.10	8.86	-	48.01	0.33	2.41	5.99	14.83	14.57	100			

SHPALOSJA E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE:

KODI 13440 - SHERBIMET KESHILLDHENESE DHE PROFESIONALE: Këtu bëjnë pjese pagesat ndaj Administratoreve të fshatrave në shumë prej 8,467.20 euro të kompensuara nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, shuma prej 1,383.00 euro nga Zyra e Kryetarit për kompensimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit, anëtarëve të KKSBB-ës dhe shuma prej 1,900.00 euro nga Drejtoria e Kultures, Rinisë dhe Sporteve për kompensimin e anëtarëve të komisioneve të themeluara për vlerësim të aplikacioneve për financim të OJQ-ve të ndryshme.

KODI 13475 - SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE: Deri në vitin 2023 shpenzimet për sigurimin fizik të objekteve kanë qenë të përfshira në kodin 13460 të shërbimeve kontraktuese tjera. Ndërsa nga viti 2024 Thesari-MFPT ka specifikuar në planin e ri kontabël kodin e veçantë për sigurimin fizik të objekteve.

KODI 13760 - DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE: Në planin e ri kontabël të hartuar nga Thesari-MFPT, këtu përfshihen: drutë, peleti, etj furnizime nga druri për nxemje.

KODI 14410 - SHPENZIMET E VENDIMEVE TË GJYKATAVE: Për Sulahe Luzha-lende përbarimore shuma 7,390.02 euro kompensim për parcela - Administrata e Përgjithshme. Për Qefserë Koraqi-lende përbarimore-padi për shpronësim prona me rastin e ndërtimit të trotuarit përgjatë rrugës Bob-Doganaj, shuma prej 3,672.34 euro dhe për Grand Construction Shpk-ZP Shala Shpk-lende përbarimore-padi për kompensim të situacionit përfundimtar të pagesës të kontratës vjetore për mirëmbajtje të rrugëve të vitit 2020, shuma prej 12,321.57 euro - Shërbimet Publike. Aliu Law Shpk - lende përbarimore të Shëndetësisë shuma prej 2,699.62 euro.

KODI 14032 - MIRËMBAJTJA E RRUGËVE LOKALE: Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve lokale për kontratën e vitit 2024 në shumë prej 99,927.16 euro, shuma prej 38,161.04 euro pagesat e obligimeve të kontratës së vitit 2023 si, shuma prej 25,039.82 euro kompensimi i inflacionit ndaj operatorëve ekonomik konform Ligjit për Punët Publike, mirëmbajtja e ndriqimit publik në shumë prej 6,799.50 euro, rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët lokale të komunës shuma prej 9,870.50 euro.

KODI 14060 - MIREMBAJTJA RUTINORE: Te Drejtoria e Shërbimeve Publike janë kryer pagesat për obligimet e vitit të kaluar në shumë prej 2,389.60 euro për mirëmbajtjen e hapsirave publike të xhelbruara sipas marrëveshjes me KRM Pastertia dhe për pagesën e obligimeve të vitit të kaluar për kontratën dekorimi i qytetit për festat e fundit, ndërsa shuma prej 18,912.90 euro janë pagesa e situacioneve për mirëmbajtjen e hapsirave xhelbruese për periudhën janar-qershor 2024 sipas marrëveshjes me KRM Pastertia për vitin 2024.

KODI 13445 - SHËRBIMET-KONSULENT DHE KONTRAKTOR INDIVIDUAL: Pagesa nga Drejtoria e Shëndetësisë ndaj mjekëve specialist të angazhuar në QKMF, shuma 7,000.00 euro.

SHPENZIMET KOMUNALE									
KODI	PERSHKRIMI	ADMINISTRATA E PERGJITHSHE	SHËNDETËSIA DHE MS	SHËRBIMET PUBLIKE	KULTURA, RINIA DHE SPORTI	ARSIMI	TOTALI TM2 2024	TOTALI TM2 2023	KRAHASIMI NE %
13210	SHPENZIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE	5,017.35	8,473.18	38,257.26	7,571.79	8,974.64	68,294.22	34,377.29	98.66
13220	SHPENZIMET E UJIT	1,186.09	67.57	55.17	675.54	2,930.14	4,914.51	2,861.57	71.74
13230	SHPENZIMET E MBETURINAVE	3,337.88	1,345.68	-	1,035.88	3,386.79	9,106.23	5,805.24	56.86
13250	SHPENZIMET E TELEFONISË FIKSE	564.84	308.68	67.73	-	1,020.99	1,962.24	1,806.60	8.62
	TOTALI	10,106.16	10,195.11	38,380.16	9,283.21	16,312.56	84,277.20	44,850.70	87.91
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET									
KODI	PERSHKRIMI	ZYRA E KRYETARIT	SHËNDETËSIA DHE MS	SHËRBIMET PUBLIKE	KULTURA, RINIA DHE SPORTI	ARSIMI	TOTALI TM2 2024	TOTALI TM2 2023	KRAHASIMI NE %
21110	SUBVENCIONE PËR ENTITETE PUBLIKE		-	14,175.00		-	14,175.00	18,200.00	(22.12)
21200	SUBVENCIONE PËR ENTITETE JOPUBLIKE		-		58,450.00	19,093.00	77,543.00	45,356.00	70.97
22200	PAGESA PËR PËRFITUES INDIVIDUAL	25,700.00	1,500.00		-	15,030.00	42,230.00	49,273.80	(14.30)
	TOTALI	25,700.00	1,500.00	14,175.00	58,450.00	34,123.00	133,948.00	112,829.80	18.72

SUBVENCIONET DHE TRANSFERET		
SHPENZIMI PER PERIUDHEN: JANAR-QERSHOR 2024		
Prog.	Përshkrimi	Planifikimi-Buxheti 2024
1	2	3
16028	Zyra e Kryetarit	70,529
18028	Drejtoria e Sherbimeve Publike	60,000
48028	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	40,000
47028	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zh.R	100,000
73037	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mbrojtja Sociale (MS)	10,000
85028	Kultura, Rinia dhe Sporti	85,000
92140	Arsimi dhe Kultura	50,000
	Totali:	415,529.00

Subvencionet dhe Transferet - ndarja në detaje

Nr. Rend.	Përshkrimi	Shpenzmet Janar - Qershor 2024
I.	ZYRA E KRYETARIT	25,700.00
1	PAGESA PER PERFITUES INDIVIDUAL-NDIHMA QASTI	10,700.00
2	OVL E UÇK - SË	12,000.00
3	Qendra per mbrojtjen e grave dhe femijeve "Shtëpia ime"	3,000.00
II.	DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE	14,175.00
1	BIK-KAÇANIK (pagesat për rastet mortore)	14,175.00
III.	PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK	-
1		-
IV.	DREJTORIA E BUJQËSISË & PYLLTARISË	-
1	Pagesa per projektin subvencionimi me koshere bletësh dhe makina centrifugë	-
2	Pagesat per mbeshtetjen e fermereve me makin mjelese	-
V.	DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE M.SOCIALE	1,500.00
1	PAGESA PER PERFITUES INDIVIDUAL	1,500.00
VI.	DREJTORIA E ARSIMIT	34,123.00
1	TRANSPORTI I NXENESEVE PER KATEGORITË E NDRYSHME	23,873.00
2	PAGESA E BURSAVE PER STUDENTË (250 euro per student-pjesa e parë)	10,250.00
VII.	DREJTORIA E KULTURES, RINISË DHE SPORTEVE	58,450.00
1	KF LEPENCI	10,000.00
2	FONDACIONI BONEVET KAÇANIK	1,400.00
3	KB KAÇANIKU MESHKUJT	2,750.00
4	KFFBBK	2,000.00
5	KLUBI BASKETBOLLISTIK LEPENCI	1,800.00
6	KLUBI MUNDJES KAÇANIKU	2,000.00
7	KLUBI I VOLEJBOLLIT KAÇANIKU	2,900.00
8	KLUBI TAEKWONDO KAÇANIKU 2000	1,750.00
9	KSH LEPENCI	2,500.00
10	KVK FEMRAT	2,000.00
11	KVRL KAÇANIK	2,000.00
12	MOTOKROSS KAÇANIKU	2,500.00
13	OKPIP KAÇANIK	1,000.00
14	NGO CAMP OF MURAL ARTISTS	2,150.00
15	QK KAÇANIKU	9,000.00
16	SHOQATA KULLA E GURIT	1,500.00
17	SHBA KAÇANIKU 2015	1,500.00
18	SHKA TINGUJT E VENDLINDJES	3,500.00
19	SHOQ.KULTURORE ARTISTIKE GRYKA E KAÇANIKUT	2,000.00
20	SHOQATA E PESHK. SPOR. REKREA. "TROFTA E LEPENCIT"	1,000.00
21	SHPKFSSHK KAÇANIK	3,200.00
Totali (I+II+III+IV) :		133,948.00

LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE JANAR QERSHOR 2024

PERSHKRIMI I PROJEKTTIT	PLANIFIKIMI	SHPENZIMI	MJETE TE LIRA	REALIZIMI NE
				%
DREJTORIA ADMINISTRATA E PERGJITHSHME	365,000.00	0.00	365,000.00	0.00
BLERJA E VETURAVE PËR NEVOJA TE ADMINISTRATES KOMUNALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDËRTIMI I ANEKSIT TË OBJEKTIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDERTIMI I PARKINGUT NENTOKËSORË PËR ADMINISTRATËS KOMUNALE	345,000.00	0.00	345,000.00	0.00
RREGULLIMI I SISTEMIT TE NGROHJES QENDRORE TE OBJEKTIT TË ADMINISTRATES	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA	230,871.60	0.00	230,871.60	0.00
MJETET PER BASHKFINANCIM TE PROJEKTEVE	230,871.60	0.00	230,871.60	0.00
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE-INFRASTRUKTURA RRUGORE	755,579.01	197,713.87	557,865.14	26.17
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatrave Llanishtë - Nikoc	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
RREG.I RRUGES BOB-KULLA HASANIT	105,000.00	30,000.00	75,000.00	28.57
RREGULLIMI I TROTUARIT NE RRUGEN BOB-DOGANAJ	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NDËRKOMUNALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDERTIMI I IMPIANTIT PER TRAJTIMIN E UJRAVE TË ZEZA	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
NDERTIMI I OBJEKTIT PER ZJARREFIKESIT - KAÇANIK	40,039.41	20,000.00	20,039.41	49.95
ASFALTIMI I RRUGES QË LIDHË FSHATRAKOTLINË-IVAJË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDËRTIMI I STAZËS PËR KËMBËSOR DHE SHTEGUT PËR BICIKLISTA PË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
RREGULLIMI I SHESHIT TE QYTETIT - FAZA I-RË	43,313.00	16,485.88	26,827.12	38.06
NDERTIMI I KOLEKTORIT KRYESORË PER TRAJTIMIN E UJRAVE TE ZEZA	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
ND,ASF RRUGËS ISMAIL RAKA,PREJ SHT.SË KUL.DERI XHAMIA DËSHMOREVE	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS IDRIZ SEFERI	105,000.00	0.00	105,000.00	0.00
VENDOSJA TABELAVE DIGJITALE ME MBISH.-MIRËSEVINI NË KAÇANIK	2,200.45	0.00	2,200.45	0.00
REHABILITIMI I DY SHETITOREVE PËRGJATË LUMIT NERODIME	12,453.60	0.00	12,453.60	0.00
RREGULLIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË FSHATIN BEGRACE	11,363.12	9,850.93	1,512.19	86.69
NDËRTIMI I FABRIKËS PËR TRAJTIMIN E UJIT TË PIJES NË SEPETIN	12,626.00	0.00	12,626.00	0.00
NDERTIMI I TROTUARIT NE RRUGEN REGIONALE AHMET KAÇIKU	75,000.00	0.00	75,000.00	0.00
RREGULLIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NË RRUGËN HETEM HASAJ-GABRRIC	51,022.18	22,347.35	28,674.83	43.80
ASFALTIMI I RRUGES KAÇANIK I VJETER - BEGRACE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
NDERTIMI I KANALIZIMEVE FEKALE DHE ATMOSFERIKE NE LOKALITETE	137,392.84	67,393.83	69,999.01	49.05
NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I RRJETEVE TË UJËSJELLËSVE NË LOKALI	75,168.41	31,635.88	43,532.53	42.09
ASFALTIMI I RRUGËS "HAMËZ JASHARI" SEGMENTI SILKAPOR - RAKAJ	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00

BUJQËSIA - KAÇANIK	52,000.00	0.00	52,000.00	0.00
NDËRTIMI I KANALEVE TË UJITJES NË FSHATRAT BIQEC,KOVAQEC DHE NIKAJ	52,000.00	0.00	52,000.00	0.00
PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - KAÇANIK	330,009.06	91,634.25	238,374.81	27.77
ND.TROT.SHTEGUT PERÇIKLIZËM,NDR.PUB NE RR.MURAT LIKA SHTRAZË	85,009.03	26,860.97	58,148.06	31.60
NDERTIMI I SHKALLEVE TE GURI SHPUAR	150,000.03	34,139.00	115,861.03	22.76
NDERTIMI I PARKUT REKREATIV NE ZONEN TURISTIKE SHTRAZË	55,000.00	30,634.28	24,365.72	55.70
NDERTIMI I SHTEGUT TË LIRISË	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
DREJTORIA E URBANIZMIT, PLANIFIKIMIT DHE MJEDISIT	1,076,146.88	114,437.84	961,709.04	10.63
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI RR.GËRLICË-K.VJETËR-STAGOVË-RUNJEVË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDERTIMI DHE RREGULLIMI I QARSHISE SE VJETER TE QYTETIT	29,771.10	0.00	29,771.10	0.00
NDËRTIMI I SHTRËTËRVE TË LUMENJËVE DHE PËRROCKAVE NË LAGJËN	180,659.17	29,825.74	150,833.43	16.51
NDERTIMI I URES MBI LUMIN NERODIME DHE MBI HEKURUDHË	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN URBANE-KAÇANIK	30,328.67	0.00	30,328.67	0.00
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN RURALE-KAÇANIK	43,392.49	0.00	43,392.49	0.00
NDERTIMI I URAVE MBI LUMIN NERODIME DHE LEPENC	132,744.00	23,824.63	108,919.37	17.95
NDERTIMI I NENKALIMIT PER KEMBESORE NEN HEKURUDHEN E QYTETIT	119,803.45	26,633.75	93,169.70	22.23
NDËRTIMI I RRUGËS DHE TROTUARIT "RESHAT SHEHU"	72,279.00	0.00	72,279.00	0.00
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN URBANE	150,000.00	13,664.47	136,335.53	9.11
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN RURALE	302,169.00	20,489.25	281,679.75	6.78
DREJTORIA E SHENDETËSISE DHE M.SOCIALE	245,000.00	4,313.64	240,686.36	1.76
FURNIZIMI ME APARATURA PËR QKMF	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
BLERJA E VETURËS PËR KUJDESHIN PALIATIV	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
NDERTIMI I DEPOS DHE GARAZHËS NË QKMF	100,000.00	0.00	100,000.00	0.00
NDERTIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I OBJKJekteve PER BANIM SOCIAL	80,000.00	4,313.64	75,686.36	5.39
NDËRTIMI I OBJEKTIT TË QPS-ËS NË KAÇANIK	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
DREJTORIA E KULTURES,RINISË DHE SPORTEVE	222,564.66	33,524.12	189,040.54	15.06
NDËRTIMI I STADIUMIT TË QYTETIT "BESNIK BEGUNCA"	6,607.10	0.00	6,607.10	0.00
NDËRTIMI DHE RIVITALIZIMI I MONUMENTEVE KULTURO-HISTORIKE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
RREGULLIMI VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-SË	45,071.50	0.00	45,071.50	0.00
BLERJA E KOMBI BUSI PER NEVOJA TE RINISË, SPORTIT DHE KULTURES	60,000.00	33,524.12	26,475.88	55.87
RREGULLIMI I TERENEVE SPORTIVE TE PALESTRA	105,886.06	0.00	105,886.06	0.00

DREJTORIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS	617,106.00	64,848.20	552,257.80	10.51
FURNIZIM ME TABELA DIGJITALE PER SHKOLLAT FILLORE DHE TE MESME	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
NDËRTIMI I QERDHES SË FËMIJËVE NË KAÇANIK TË VJETËR	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
BLERJA DHE INSTALIMI I POMPAVE TERMIKE NE QEAP AGIMI	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
NDERTIMI I SHFMU - EMIN DURAKU- KAÇANIK	55,500.00	0.00	55,500.00	0.00
NDËRTIMI I QERDHES SË FËMIJËVE NË KAÇANIK TË VJETËR	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
FURNIZIM ME TABELA DIGJITALE PER SHKOLLAT FILLORE DHE TE MESME	20,000.00	14,848.20	5,151.80	74.24
NDERTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NE SHFMU IDRIZ SEFERI	200,000.00	0.00	200,000.00	0.00
NDERTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NE SHFMU JUSUF GËRVALL	100,000.00	50,000.00	50,000.00	50.00
NDERTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NE SHFMU NAZMI OSMANI	6,144.00	0.00	6,144.00	0.00
NDERTIMI I KULMIT TE SHKOLLES FILLORE "QAMIL ILAZI" NE KAÇAN	2,564.00	0.00	2,564.00	0.00
NDËRRIMI I KULMIT TË SHFMU "AGIM BAJRAMI" STAGOVË	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
VENDOSJA E ASHENSORIT NË GJIMNAZIN SKENDERBEU-KAÇANIK	2,898.00	0.00	2,898.00	0.00
NDËRTIMI I ANEKSIT TË IAAP- FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA	150,000.00	0.00	150,000.00	0.00
TOTAL SHPENZIMI JANAR-QERSHOR 2024	3,894,277.21	506,471.92	3,387,805.29	13.01



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Zyra e Kryetarit

Nr. 01-104/02-16337
Kaçanik; 12.07. 2024

PËR/ZA/TO:	ZYREN E KUVENDIT KOMUNAL – KRYESUESIT Z. KEMAJL MËRSELI
NGA/OD/FROM:	Besim Ilazi – Kryetar Komune-ZKA
PËRMES:	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2023


I Nderuar Kryesues i Kuvendit,

Bashkëngjitur me këtë shkresë po iu dergojmë Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare 'PVF' Komunës së Kaçanikut për vitin 2023 për shqyrtim dhe diskutim në seancën e ardhshme e cila do të zhvillohet nga Asambleja Komunale.

Me respekt;



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kaçanikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Baza për konkluzion

- A1 Për pagesat në vlerë prej 273,674€ nuk ishin respektuar hapat për procedim të pagesave.
- A2 Tejkallim i kontratës publike kornizë çmim njësi për 29,309€.
- A3 Zyra e prokurimit kishte specifikuar brendin në dosjen e tenderit.
- B1 Komuna kishte lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues.
- A4 Komuna nuk kishte bërë konfiskimin e sigurimit të tenderit edhe pse Operatori Ekonomik ishte tërhequr nga ofrimi i dokumenteve të përshtatshmërisë.
- A5 Mosrespektimi i kërkesave ligjore me rastin e kompensimit për punën jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës.
- A6 Kompensimi i dy zyrtarëve për pozitën e kryeinfermierit, megjithëse kjo pozitë ushtrohet vetëm nga njëri prej tyre.
- B2 Vonesa në deponimin e mjeteve monetare të mbledhura në llogarinë bankare.
- A7 Moskryerja e obligimeve brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kaçanikut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kaçanikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kaçanikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kaçanikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë të mjaftueshme dhe të ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kaçanikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: te kategori e pagave dhe mëditjeve, mungesë e projektit ekzekutiv, mosdeponim me kohë i mjeteve monetare të mbledhura nën 10€, mangës në lidhje me përdorimin e e-platfomës së prokurimit publik, dobësi në regjistrimin e pasurive, vonesa në inkasmin e llogarive të arkëtueshmëve, dobësi në fushën e prokurimit.

Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në Raportin Vjetor Financiar, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja dhe gjashtë (6) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare

Gjetja

Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 21 mostrat e testuara në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejt se në 19 raste në vlerë 273,674€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimit/furnizimet pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhërblerja.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e financave dhe prokurimit pasi që zyrtari zotues dhe zyra e prokurimit nuk i kishin respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullës financiare.

Ndikimi

Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Tejkallim i kontratës

Gjetja

Neni 54.15 i Rregullores Nr 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi". Po ashtu neni 25 paragrafi 1.2 i Rregullës financiare nr. 01/2013 MF shpenzimi i parave publike parasheh "Çertifikuesi të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave".

Komuna me datën 31.12.2021, kishte lidhur kontratë publike kornizë me çmim për njësi për "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale" në vlerë 475,000€. Sipas raportit të menaxherit të kontratës punë të kryera me këtë kontratë ishin 504,309€, ku si tejkallim kemi 29,309€.

Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të mirë të kontratës si dhe çertifikimit të pagesës jo në pajtim me kërkesat ligjore.

Ndikimi Tejkalmi i kontratave ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paarsyeshme dhe të paplanifikuara të parasë publike si dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave dhe pagesat mos të bëhet pa u siguruar se kontrata po zbatohet në mënyrë që të mos bëhet tejkalmi i tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Specifikimi i brendit në dosjen e tenderit

Gjetja Neni 17 paragrafi 2 i Rregullores Nr 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se " Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajn, lloj, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër. Kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për karakterizimin e kërkesave përveç referencës, përshkrimi do të përdoret, pasuar nga fjalët "ose të barasvlershme".

Te projekti "Rregullimi i muzeut në Kaçanik" në vlerë 61,999€, zyra e prokurimit kishte lëshuar dosjen e tenderit duke specifikuar në paramasën dhe parallogarinë brendin (markën e caktuar). Brendi ishte specifikuar tek pozicioni 5 Sigurimi, transporti dhe montimi i TV LED Samsung.

Kjo ka ndodh për shkak të dështimit të zyrës së prokurimit për ta parandaluar përdorimin e brendit në dosjen e tenderit.

Ndikimi Specifikimi i brendit në dosjen e tenderit mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës dhe trajtimit jo të barabartë të operatorëve ekonomik.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit nuk do ta lëshoj dosjen e tenderit nëse në paramasën dhe parallogarinë e dosjes specifikohet brendi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mungesa e projekteve ekzekutuese

Gjetja Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Në tre (3) raste komuna kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhë kontratë pa hartuar projekt ekzekutiv. Rastet ishin te projekti "Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriçimit publik në rrugën Murat Lika Strazhë" në vlerë 122,852€, "Rregullimi dhe renovimi i infrastrukturës shëndetësore dhe sociale" në vlerë 110,777€, dhe "Rregullimi i muzeut Kaçanik" në vlerë 61,999€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike.

Ndikimi

Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit, dhe rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B1

Kryetari të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Moskonfiskimi i sigurimit të tenderit

Gjetja

Neni 28.8 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh "Autoriteti Kontraktues (AK) do të konfiskoj sigurimin e tenderit në situatat: 1. AK konstaton që Operatori Ekonomik (OE) ka dorëzuar informata të pavërteta ose mashtruese; 2. OE tërheq tenderin e tij pas afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së validitetit të tenderit; dhe 3. OE fiton kontratën por refuzon ose dështon të ofroj sigurimin e ekzekutimit, siç specifikohet në Dosjen e Tenderit (DT); b. Të respektoj kushtet tjera që paraprijnë nënshkrimin e kontratës, siç specifikohet në DT; ose c. Të përformoj kontratën, sipas specifikimeve në DT.

Në procedurën e prokurimit për projektin "Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike", komuna kishte propozuar dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik (OE), i cili ishte vlerësuar si i përgjegjshëm. Komuna kërkoi nga OE që të ofronte dëshmitë e përshtatshmërisë (vërtetimin nga ATK dhe vërtetimin nga Gjykata) për të përmbushur kërkesat për nënshkrimin e kontratës. OE nuk i ofroi këto dokumente e kërkuara. Si rezultat, OE nuk u shpërblye me kontratë, por komuna nuk e kishte konfiskuar sigurimin e tenderit edhe pse ishte e obliguar ta bënte këtë.

Kjo ka ndodh për shkak të anashkalimit të rregullave nga ana zyra e prokurimit për ta konfiskuar sigurinë e tenderit nga OE.

Ndikimi

Moskonfiskimi i sigurisë së tenderit ndikon që të hyrat komunale të jenë më të ulta në anën tjetër, kjo mund të ndikoj që OE mos të përfillin rregullat edhe në rastet tjera tenderuese.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të shtoj kontrollet ndaj zyrës së prokurimit dhe në rastet kur OE tërhiqen gjatë procesit të tenderimit të bëhet konfiskimi i sigurisë së tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mosrespektimi i kërkesave ligjore me rastin e kompensimit për punën jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës

Gjetja

Neni 7 i Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për Kujdestari, Punën Gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës nder tjerash parasheh se "Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuar ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ka autorizim paraprak të arsyetuar nga udhëheqësi më i lartë i institucionit". Po ashtu Ligji Nr. 03/L-212 i Punës parasheh se "Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë me gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë.

Drejtori i QKMF-së gjatë vitit 2023, pa bërë ndonjë analizë dhe një plan të mirëfillët për nevojat e QKMF-së për punën shtesë jashtë orarit të rregullt të punës dhe pa marrë autorizim nga udhëheqësi më i lartë i institucionit, rregullisht gjatë fundjavës (çdo të diele) kishte angazhuar një pjesë të stafit të punonte me orar 12 orësh si punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës edhe pse ky angazhimi i tyre nuk kishte të bëjë me raste të jashtëzakonshme a po me rritjen e vëllimit të punëve. Përveç tjerash, angazhimi i tyre tejkalon orët shtesë të lejuar në javë me ligj (tetë 8 orë në javë).

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolli të dobët të menaxhmentit të QKMF-së në njërën anë dhe koordinimit jo të mirë në anën tjetër në mes Drejtorit të QKMF-së dhe Kryetarit të Komunës me rastin e autorizimeve paraprake për orët shtesë.

Ndikimi

Angazhimi i stafit për punët jashtë orarit të rregullt pa autorizim paraprak nga Kryetari, pa pasur raste të jashtëzakonshme dhe pa u rritur vëllimi i punës mund të ndikoj në dëmtimin e buxheti të komunës.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se angazhimi i stafit për punë jashtë orari të rregullt do të bëhet vetë pasi që është bërë një planifikim dhe një analizë e mirëfilltë për nevojat si në rastet e jashtëzakonshme a po kur të rritet vëllimi i punës dhe autorizohet paraprakisht nga Kryetari i Komunës. Në rastet kur ka nevojë që stafi të angazhohet jashtë orarit të rregullt puna e tyre mos ta tejkaloj 8 orë në javë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Kompensimi i dy zyrtarëve për pozitën kryeinfermier edhe pse kjo pozitë ushtrohet vetëm nga njëri prej tyre

Gjetja

Me organogramin e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Kaçanikut është e paraparë një pozitë e kryeinfermierit.

Në QKMF dy të punësuar janë me kontratë të punës në pozitën e kryeinfermierit edhe pse me organogram është e paraparë një pozitë. Më tutje, pas diskutimit të kësaj çështje, QKMF e ka konfirmuar se njëri kryeinfermier gjatë vitit 2023, kishte ushtruar pozitën e depoistit e jo të kryeinfermierit, përderisa në kemi vërejtur se pagesa ishte bërë si kryeinfermier.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve jo të mira të bëra nga menaxhmenti i komunës me rastin e menaxhimit të kësaj pozite.

- Ndikimi** Pagesa për pozitën e kryeinfermierit për pa e ushtruar (kryer punën e kryeinfermierit) mund të ndikoj në kryerjen e pagesave të parregullta.
- Rekomandimi A6** Kryetari duhet të ndërmerr veprime për ta rregulluar pozitën e kryeinfermierit në QKMF në pajtim me organogramin e drejtorisë së shëndetësisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në dorëzimin e parave të mbledhura tek arkatari

- Gjetja** Neni 11 paragrafi 2 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat parasheh se "Në fund të ditës paratë e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të të hyre përmes agjencive mbledhëse me faturë përmbledhëse të përcaktuara me numrin identifikues UNIREF.

Nga testimi i të hyrave ka rezultuar se zyrtarët e komunës parat (të hyrat) e mbledhura nga lëshimi i çertifikatave dhe ekstrakteve të lindjes i kishin mbajtur nga një javë deri në gjashtë muaj të pa dorëzuara tek arkatari i komunës.

Kjo ka ndodh për shkak të mungesës së përgjegjësisë së zyrtarëve që punojnë në gjendjen civile që parat e grumbulluara nga çertifikatat dhe ekstraktet e lindjes t'i dorëzojnë me kohë tek arkatari.

- Ndikimi** Mosdorëzimi i parave të gatshme brenda ditës nga lëshimi i çertifikatave për tu deponuar në llogari bankare mund të ndikoj në humbjen a po tjetërsimin e parave të mbledhura.

- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se paratë e grumbulluara nga lëshimi i çertifikatave do të dorëzohen me kohë tek arkatari në mënyrë që parat të deponohen në bankë në llogarinë e komunës në fund të ditës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara

- Gjetja** Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në pesë (5) raste në vlerë 55,991€, kemi vërejtur se komuna nuk i kishte kryer obligimet financiare brenda afatit prej 30 ditësh. Vonesat ishin deri në gjashtë muaj nga data e pranimi të faturës.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë

buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2023, ishte 1,754,000€, prej tyre ishin shpenzuar 1,688,554€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për derivate, riparim dhe mirëmbajtje, furnizim me lëndë djegës, komunalitë etj

Çështja A8 - Keqklasifikim i shpenzimeve

Gjetja Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve duke paguar 65,128€, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të cilat për nga natyra ekonomike i takojnë investimeve kapitale. Pagesat kanë të bëjë me rregullimin e oborreve me kubëza të objektet për banim social, qendrës së mjekësisë familjare në Doganaj dhe muzeun e qytetit si dhe punët e kanalizimit fekal.

Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar të shpenzimeve gjatë hartimit të buxhetit nga ana e komunës.

Ndikimi Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategori të ndryshme si dhe prezantim jo të saktë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".

Menaxheret e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo të duhura nga ana e menaxherëve të projekteve që menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës ta bëjë përmes platformës së e-prokurimit.

- Ndikimi** Mosmbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.
- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mungesa e dokumenteve që ndërlidhen me kërkesat e përshtatshmërisë në platformën elektronike të prokurimit publik

- Gjetja** Pika 47.16 e Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Verifikimi i përshtatshmërisë dhe kualifikimeve të ofertuesve, bëhet përmes Letrës standarde B47 Kërkese për sqarimin e tenderit/aplikacionit përmes platformës elektronike".
- Kemi vërejt se dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të përshtatshmërisë për fituesin e kontratës siç janë vërtetimi nga gjykata kompetente, vërtetimi i ATK-së nuk ishin vendosur në platformën elektronike të e-prokurimit. Rastet janë vërejtur te kontrata "Shërbimet e sigurimit fizik për objektet e komunës" në vlerë 94,676€ dhe te "Furnizim me pajise mjekësore" në 15,896€.
- Kjo ka ndodhur, pasi që zyra e prokurimit kishte kërkuar nga fituesit e kontratave që dokumentet në fjalë të dorëzohen në formë origjinale në zyrën e prokurimit në komunë, e jo në platformën elektronike.
- Ndikimi** Mungesa e dokumenteve të përshtatshmërisë në platformën elektronike ndikon në mosrespektimin e transparencës në procesin e prokurimit dhe në mos marrjen e informatave në mënyrë elektronike nga përdoruesit e lejuar.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek zyra e prokurimit për të siguruar se të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2023 ka shpalosur në PVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 1,973,138€.

Çështja B5 - Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme në PVF

Gjetja	Neni 16 i rregullores 01/2017 Për raportim vjetor nga Organizata Buxhetore përcakton "Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të obliguara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave". Llogaritë e arkëtueshme të raportuara në vlerë prej 1,973,138€ në nenin 16 të PVF-së nuk ishin të sakta për shkak se 10,218€ ishin prezantuar si llogari e arkëtueshme tek shfrytëzimi i pronës publike përderisa nuk është dashtë të prezantohen për faktin se gjykata ka konstatuar se lëndët janë parashkruar, po ashtu regjistri i marrë nga zyrtari i cili merret me menaxhimin e këtyre të arkëtueshmeve ka vlerën 49,037€, përderisa në PVF janë prezantuar 58,927€, pra një diferencë prej 9,890€. Më tutje, komuna për tre mostra në vlerën 4,860€, për llogarit e arkëtueshme për taksat e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishte në gjendje të na ofronte shënimet (të dhëna) si faturat a po kartelat financiare në lidhje me këto të arkëtueshme. Kjo ka ndodh për shkak se zyrtarët që merren me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme nuk kanë mbajtur dhe azhurnuar dosjet dhe regjistrat e llogarive të arkëtueshme si duhet.
Ndikimi	Mos mbajtja e regjistrave dhe dosjeve sipas kërkesave ligjore ndikon që llogaritë e arkëtueshme të raportuara në PVF të mos raportohen drejtë dhe krijon paqartësi tek përdoruesit e saj.
Rekomandimi B5	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët që merren me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme do të azhurnojë dhe mbajnë regjistra të saktë të llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja	Neni 26 Ligji nr.06/L-005 Për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton se Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e 10€. Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2023, komuna ndërmori veprime për të mbledhur borxhet duke dërguar faturat e shfrytëzimit të pronës publike në përmbarim, llogaritë e arkëtueshme në total, krahasuar me vitin e kaluar, janë rritur nga 1,830,089€, në 1,973,138€, duke shënuar një diferencë prej 143,049€, ose rreth 7%. Rritja më e madhe është vërejtur te tatimi mbi pronën.
---------------	---

Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	10,674,689	12,035,894	11,159,685	8,975,661	8,653,621
Grante Qeveritare - Buxheti	9,812,111	10,348,479	10,345,461	8,111,286	7,839,535
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	73,968	22,929
Të bartura nga viti i kaluar	0	814,723	440,514	386,278	365,273
Të hyrat vetanake	862,578	862,578	368,928	395,449	404,714
Donacionet vendore	0	10,115	4,781	8,680	21,169

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,361,205€. Kjo rritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, financimit nga huamarrja si dhe donacioneve.

Në vitin 2023 komuna ka shpenzuar rreth 93% të buxhetit përfundimtar. Kjo paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	10,674,689	12,035,894	11,159,685	8,975,661	8,653,621
Pagat dhe mëditjet	5,621,607	6,157,975	6,157,975	5,069,788	5,058,048
Mallrat dhe shërbimet	1,498,269	1,554,000	1,540,810	969,418	826,344
Komunalitë	193,500	200,000	147,744	176,626	188,597
Subvencionet dhe transferet	390,000	413,874	360,285	322,604	300,804
Investimet Kapitale	2,851,313	3,710,045	2,952,871	2,437,225	2,279,828
Rezervat	120,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 536,368€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje është bërë nga granditë qeveritar (fondi 10) për të mbuluar koston shtesë të pagave, që erdhi si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të pagave në sektorin publik.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 55,731€. Rritja ishte si rezultat i bartjes së fondeve me vendim të Kuvendit Komunal nga investimet kapitale (34,003€), komunalit (10,000€) dhe subvencione dhe transfere (8,500€), në kategorinë mallra dhe shërbime, rritje nga donacionet për 2,400€ si dhe rritje nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2022, për 828€.
- Buxheti final për shpenzime komunale ishte rritur për 6,500€, krahasuar me buxhetin fillestar. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2022, në vlerë 16,500€, si dhe me vendim nga Kuvendi Komunal nga granditë qeverisë ishin transferuara 10,000€, nga komunalit në mallra dhe shërbime.
- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për subvencione ishte rritur për 23,874€, nga kjo vlerë: 24,806€, ishin rritje nga të hyrat vetjake të bartura, pastaj rritje nga granditë donatorëve prej 7,568€, si dhe një zvogëlim prej 8,500€, ku me vendim të Kuvendit Komunal nga kjo kategori ishin transefuar fondet në kategorinë mallra dhe shërbime.
- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 858,732€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave vetjake të pashpenzuara nga viti 2022 në vlerë 772,588€, rritje nga transferi i rezervës me vendim të Kuvendit Komunal në vlerë 120,000€, për financimin e projekteve kapitale, rritje nga donacionet në vlerë 147€, si dhe zvogëlim për 34,003€, ku me vendim nga Kuvendi Komunal nga kjo kategori ishin transefuar fondet në kategorinë mallra dhe shërbime.

Fondet e shpenzuara në vitin 2023 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 6,285€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2023 ishin 862,578€, përderisa ishin realizuar 884,219€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 166,542€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 41,986€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	862,578	862,578	884,219	682,981	802,799
Të hyrat tatimore	410,966	410,966	443,998	380,303	374,793
Të hyrat jo tatimore	451,612	451,612	440,162	302,678	428,006
Të hyrat tjera	0	0	59		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022, kishte rezultuar me 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2022 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë, katër (4) rekomandime janë zbatuar, dhe gjashtë (6) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se mjetet monetare të grumbullara nga taksa për regjistrimin e automjeteve dhe certifikatave do të deponohen në fund të ditës.	Edhe në vitin 2023 kishte vonesa në dorëzimin e fondeve të mbledhura nën 10€.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Edhe në vitin 2023 menaxherët e projektit menaxhimi nuk e kanë bërë përmes platformës elektronike.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së RVF, zbatohen procedurat adekuatë të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme.	Komuna ende ka probleme me regjistrat e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin

4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të lejojë pagesë në paradhënie nëse një gjë e tillë nuk është e paraparë me kushte të veçanta të dosjes së tenderit dhe me kontratë të lidhur mes komunës dhe operatorit ekonomik.	Nuk kemi hasur ndonjë çështje të kësaj natyre.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se në rastet kur ka ndryshime materiale të pozicioneve të realizuara krahas të pozicioneve kontraktuara kontratat e tilla të ndërpriten.	Nuk kemi hasur ndonjë çështje të kësaj natyre	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek zyra e prokurimit për të siguruar se të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik.	Edhe në vitin 2023, kishte raste kur dokumentet e përshtatshmërisë nuk ishin në platformë	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve do të raportojnë me shkrim në lidhje me përmbushjen e kontratës nga operatori ekonomik si dhe certifikimi i pagesës të bëhet vetëm pasi që është siguruar raporti me shkrim nga menaxherët e projekteve.	Nga testimi i mostrave nuk kemi hasur ndonjë çështje.	I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Edhe në vitin 2023 kishte mungesë të projekteve ekzekutive.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Komuna kishte zbatuar rekomandimin dhe pasurit i kishte regjistruar sipas kërkesave ligjore.	I zbatuar
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e tyre.	Kishte rritje të llogarive të arkëtueshme sidomos tek tatimi në pronë.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit




Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik/ Municipality of Kaçanik

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Besim Ilazi- Kryetar i Komunës

Data: 29. maj. 2024, Kaçanik



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik




1	Data	2.07.24	Vendi	KAÇANIK
2	Org.		Numri	Shtoiç
		01	104/02-163	1.

Për Kuvendin Komunal-Kaçanik;

Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga z.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Datë 12/07/2024



PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit për PFV'2023

Nr.	Komponenta e Auditimit (Kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja A1 Mosrespektimi i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare	Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë. Nga 21 mostrat e testuara në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejt se në 19 raste në vlerë 273,674€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimit/furnizimet pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhërblerja.	Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Do të shtohet kontrolli i menaxhimit të procesit të pagesave nga Zyra e financave në kordinim të plotë me Zyren e Prokurimit. Do të respektohet ne përpikëri procedura sipas librit të proceseve.	Udhëheqësi i Zyres së Prokurimit, Kryetari i Komunes, Zyrtari i zotimeve, çertifikuesi dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i komunës.	Janar – Dhjetor 2024	-
2	Çështja A2 Tejkalimi i kontratës	Neni 54.15 i Rregullores Nr 001/2022 për Prokurimin Publik parashihet "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategorie të shërbimeve" ose secilit artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët.	Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmasat menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave dhe pagesat mos të bëhet pa u	Do të ndërmirren masat që të mos paraqitet tejkalimi i kontratave sepse mund të ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paarsyeshme dhe të paplanifikuara të parashë publike si	Udhëheqësi i Zyres së Prokurimit, Menaxheri i Kontates, Kryetari i Komunes, Zyrtari çertifikues dhe Zyrtari Kryesor	Janar – Dhjetor 2024	

		Ne këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh.mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi". Po ashtu neni 25 paragrafi 1.2 i Rregullës financiare nr. 01/2013 MF shpenzimi i parave publike parasheh " Çertifikuesi të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave".	siguruar se kontrata po zbatohet në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.	dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.	Financiar (ZKF).	
3	Çështja A3 Specifikimi i brendit në dosjen e tenderit	Neni 17 paragrafi 2 i Rregullores Nr 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se " Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajni, lloji, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër. Kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për karakterizimin e kërkesave përveç referencës, përshkrimi do të përdoret, pasuar nga fjalët "ose të barasvlershme". Te projekti "Rregullimi i muzeut në Kaçanik" në	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit nuk do të lëshoj dosjen e tenderit nëse në paramasën dhe paralogarinë e dosjes specifikohet brendi.	Nuk do të përsëritet rasti në specifikim të brendit në dosjen e tenderit përshkak se mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës dhe trajtimit jo të barabartë të operatorëve ekonomik.	Zyrtari i pranimit të mjeteve nga njësitë gjeneruese në kordinim të plotë me Zyrtarin Kryesor Financiar të Komunes si personi përgjegjës për vendosjen dhe monitorimin e	Janar – Dhjetor 2024

4	Çështja B1 Mungesa e projekteve ekzekutuese	vlerë 61,999€, zyra e prokurimit kishte lëshuar dosjen e tenderit duke specifikuar në paramasën dhe parallogarinë brendin (markën e caktuar). Brendi ishte specifikuar tek pozicioni 5 Sigurimi, transporti dhe montimi i TV LED Samsung. Kjo ka ndodh për shkak të dështimit të zyrës së prokurimit për ta parandaluar përdorimin e brendit në dosjen e tenderit.	Kryetari të sigurojë kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Do të behet hartimi i projekteve ekzekutuese dhe do të shmangen elementet që mund të shkaktojnë vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit, poashtu ashtu synojmë që të eliminohen edhe vonesat e punimeve si dhe rritjet e kostove të projekteve të cilat mund të ndodhin nese projektet nuk i kemi të hartuara mirëfilli në kohën e	Zyra e Kryetarit, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Urbanizmit.	Janar – Dhjetor 2024	kontrollit të bëndshëm financiar.		
---	--	--	---	--	--	-----------------------------	--	--	--

		shëndetësore dhe sociale" në vlerë 110,777€, dhe "Rregullimi i muzeut Kaçanik" në vlerë 61,999€. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike.			duhur.			
5	Çështja A4 Moskonfiski mi i sigurimit të tenderit	Neni 28.8 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh "Autoriteti Kontraktues (AK) do të konfiskoj sigurimin e tenderit në situatat: 1. AK konstaton që Operatori Ekonomik (OE) ka dorëzuar informata të pavërteta ose mashtruese; 2. OE tërheq tenderin e tij pas afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së validitetit të tenderit; dhe 3. OE fiton kontratën por refuzon ose dështon të ofrojë sigurimin e ekzekutimit, siç specifikohet në Dosjen e Tenderit (DT); b. Të respektoj kushtet tjera që paraprijnë nënshkrimin e kontratës, siç specifikohet në DT; ose c. Të përformoj kontratën, sipas specifikimeve në DT. Në procedurën e prokurimit për projektin "Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike", komuna kishte	Kryetari duhet të shtoj kontrollin ndaj zyrës së prokurimit dhe në rastet kur OE tërhiqen gjatë procesit të tenderimit të bëhet konfiskimi i sigurisë së tenderit.	Do të ndërmerren masat e nevojshme që të ndodhë konfiskimi i sigurisë së tenderit me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së të hyrave vetanake si dhe do të ngritet niveli i përgjegjësisë nga OE që të përfillen rregullat në të gjitha rastet tjera tenderuese.	Zyra e Prokurimit	Janar – Dhjetor 2024		

		propozuar dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik (OE), i cili ishte vlerësuar si i përgjegjshëm. Komuna kërkoi nga OE që të ofronte dëshmitë e përshtatshmërisë (vërtetimin nga ATK dhe vërtetimin nga Gjykata) për të përmbushur kërkesat për nënshkrimin e kontratës. OE nuk i ofroi këto dokumente e kërkuara. Si rezultat, OE nuk u shpërblye me kontratë, por komuna nuk e kishte konfiskuar sigurimin e tenderit edhe pse ishte e obliguar ta bënte këtë.					
6	Çështja A5 Mosrespekti mi i kërkesave ligjore me rastin e kompensimit për punën jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës.	Neni 7 i Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për Kujdestari, Punën Gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës nder tjerash parasheh se "Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuar ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ka autorizim paraprak të arsyetuar nga udhëheqësi më i lartë i institucionit". Po ashtu Ligji Nr. 03/L-212 i Punës parasheh se "Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë me gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në	Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se angazhimi i stafit për punë jashtë orarit të rregullt do të bëhet vetë pasi që është bërë një planifikim dhe një analizë e mirëfilltë për nevojat si në rastet e jashtëzakonshme a po kur të rritet vëllimi i punës dhe autorizohet paraprakisht nga Kryetari i Komunës. Në rastet kur ka nevojë që stafi të angazhohet jashtë	Nuk do të behet me tutje angazhimi i stafit për punët jashtë orarit të rregullt pa autorizim paraprak nga Kryetari, pa pasur raste të jashtëzakonshme dhe pa u rritur vëllimi i punës. Procedurat janë duke u zhvilluar sipas legjislacionit ne fuqi.	Drejtoria e Shëndetësisë; Zyra e Personelit dhe Zyra e Kryetarit.	Janar – Dhjetor 2024	

		tetë (8) orë në javë. Në QKMF-së gjatë vitit 2023, pa bërë ndonjë analizë dhe një plan të mirëfillët për nevojat e QKMF-së për punën shtesë jashtë orarit të rregullt të punës dhe pa marrë autorizim nga udhëheqësi më i lartë i institucionit, rregullisht gjatë fundjavës (çdo të diele) ishin angazhuar një pjesë të stafit të punonte me orar 12 orësh si punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës edhe pse ky angazhimi i tyre nuk kishte të bëjë me raste të jashtëzakonshme a po me rritjen e vëllimit të punëve. Përveç tjerash, angazhimi i tyre tejkalon orët shtesë të lejuar në javë me ligj (tetë 8 orë në javë).	orarit të rregullt puna e tyre mos ta tejkalon 8 orë në javë .			
7	Çështja A6 Kompensimi i dy zyrtarëve për pozitën kryeinfiermie r edhe pse kjo pozitë ushtrohet vetëm nga njëri prej tyre	Me organogramin e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Kaçanikut është e paraparë një pozitë e kryeinfiermierit. Në QKMF dy të punësuar janë me kontratë të punës në pozitën e kryeinfiermierit edhe pse me organogram është e paraparë një pozitë. Më tutje, pas diskutimit të kësaj çështje, QKMF e ka konfirmuar se njëri kryeinfiermier gjatë vitit 2023, kishte ushtruar pozitën e depoistit e jo të kryeinfiermierit, përderisa ne kemi vërejtur se pagesa ishte bërë si kryeinfiermier.	Kryetari duhet të ndërmerr veprime për ta rregulluar pozitën e kryeinfiermierit në QKMF në pajtim me organogramin e drejtorisë së shëndetësisë.	Sa i përket kesaj çështje, ne pamundësi të gjetjes se një pozite ekuivalente me pozitën e kryeinfiermierit në ligjin e ri të pagave ende nuk kemi mundur të ndërmarrim veprime tjera përveç asaj që njëri prej kryeinfiermierëve është duke e kryer	Drejtorja e Shëndetësisë; Zyra e Personelit dhe Zyra e Kryetarit.	Janar – Dhjetor 2024

				përkohesisht detyrën si Përgjegjës I depos. Komuna do të ketë parasysh që me riorganizimin e ri të QKMF-së, përkatesisht në Rregulloren e re për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të ndermerr veprimet e nevojshme lidhur me kete çështje.			
8	Çështja B2 – Vonesa në dorëzimin e parave të mbledhura tek arkatari	Neni 11 paragrafi 2 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat parasheh se "Në fund të ditës paratë e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të të hyre përmes agjencie mbledhëse me faturë përmbledhëse të përcaktuara me numrin identifikues UNIREF. Nga testimi i të hyrave ka rezultuar se zyrtarët e komunës parat (të hyrat) e mbledhura nga lëshimi i certifikatave dhe ekstrakteve të lindjes i kishin mbajtur nga një javë deri në gjashtë muaj të pa dorëzuara tek arkatari i komunës.	Kryetari duhet të sigurojë se paratë e grumbulluara nga lëshimi i certifikatave do të dorëzohen me kohë tek arkatari në mënyrë që parat të deponohen në bankë në llogarinë e komunës në fund të ditës.	Përkunder vështiresive të cilat ekzistojnë pershkak te ekzistimit te Zyrave Ofiqare ne zonat e largëta, do te vazhdohet me dorezimin e parave të gatshme brenda ditës nga lëshimi i certifikatve për tu deponuar në llogari bankare. Është planifikuar ti dërgohet propozim vendimi Kuvendit	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Drejtoria e Financave.	Janar – Dhjetor 2024	

		Kjo ka ndodh për shkak të mungesës së përgjegjësisë së zyrtarëve që punojnë në gjendjen civile që parat e grumbulluara nga çertifikatat dhe ekstraktet e lindjes t'i dorëzojnë me kohë tek arkëtari.	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave	Komunal për mbylljen e zyreve të vendit të cilat operojnë nëpër fshatra.	Drejtoria per Buxhet dhe Financa; Gjithë mbajtësit e buxheteve.	Mars – Dhjetor 2024	
9	Çështja A7 Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara	Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore". Në pesë (5) raste në vlerë 55,991€, kemi vërejtur se komuna nuk i kishte kryer obligimet financiare brenda afatit prej 30 ditësh. Vonesat ishin deri në gjashtë muaj nga data e pranimit të faturës. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.					
10	Çështja A8	Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për	Kryetari duhet të sigurojë se	Do të shtohet kontrolli ne fazen e	Drejtoria per Buxhet dhe	Janar – Dhjetor 2024	

	Keqklasifikim i shpenzimeve	Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatese të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë. Komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve duke paguar 65,128€, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të cilat për nga natyra ekonomike i takojnë investimeve kapitale. Pagesat kanë të bëjë me rregullimin e oborreve me kubëza të objektet për banim social, qendrës së mjekësisë familjare në Doganaj dhe muzeun e qytetit si dhe punët e kanalizimit fekal.	shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	zotimit të mjeteve buxhetore rreth klasifikimit adekuat te shpenzimeve në mënyrë që të mos ndikohet në mbivlerësim/nënvl erësim të shpenzimeve në kategori të ndryshme si dhe te mos ndodhë prezantim jo të saktë të shpenzimeve në PVF.	Financa	
11	Çështja B3 Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e- prokurimit	Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik". Menaxheret e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Me qellim të një menaxhimi më efektiv të kontratave si dhe sigurimit me real të informatave lidhur me progresin e realizimit të kontratave, do të behët arkivimi dhe mbajtja përmes sistemit elektronik te prokurimit per gjitha kontratat. Ky	Zyra e Prokurimit dhe Menaxheret e Projekteve.	Janar – Dhjetor 2024

		kontraktuesve. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo të duhura nga ana e menaxherëve të projekteve që menaxhimin e kontratave dhe vlerësimit e performances ta bëjë përmes platformës së e-prokurimit.		aktivitet deri me tani nuk ka mundur të aplikohet pershkak te mungeses se zhvillimit te trajnimit adekuat per menaxheret e kontratave.		
12	Çështja B4 Mungesa e dokumenteve që ndërlidhen me kërkesat e përshatshmërisë në platformën elektronike të prokurimit publik	Pika 47.16 e Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Verifikimi i përshatshmërisë dhe kualifikimeve të ofertesve, bëhet përmes Letrës standarde B47 Kërkesë për sqarimin e tenderit/aplikacionit përmes platformës elektronike”. Kemi vërejt se dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të përshatshmërisë për fituesin e kontratës siç janë vërtetimi nga gjykata kompetente, vërtetimi i ATK-së nuk ishin vendosur në platformën elektronike të e-prokurimit. Rastet janë vërejtur te kontrata "Shërbimet e sigurimit fizik për objektet e komunës" në vlerë 94,676€ dhe te "Furnizim me pajise mjekësore" në 15,896€.	Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek zyra e prokurimit për të siguruar se të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik.	Do të ndërmerren masat e nevojshme që të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik.	Zyra e Prokurimit	Janar – Dhjetor 2024
13	Çështja B5 Mbivlerësimi i Llogarive të arkëtueshme	Llogaritë e arkëtueshme të raportuara në vlerë prej 1,973,138€ në nenin 16 të PVF-së nuk ishin të sakta për shkak se 10,218€ ishin prezantuar si llogari e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët që merren me menaxhimin e	Do të arrihet te sigurohet nje shkallë me e lartë e angazhimit te zyrtarëve	Zyrtaret përgjegjës të cilët janë të angazhar sipas drejtorive	Janar – Dhjetor 2024

	në PVF	tek shfrytëzimi i pronës publike përderisa nuk është dashtë të prezantohen për faktin se gjykata ka konstatuar se lëndët janë parashkruar, po ashtu regjistrat e marrë nga zyrtari i cili merret me menaxhimin e këtyre të arkëtueshmeve ka vlerën 49,037€, përderisa në PVF janë prezantuar 58,927€, pra një diferencë prej 9,890€. Më tutje, komuna për tre mostra në vlerën 4,860€, për llogarit e arkëtueshme për taksat e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishte në gjendje të na ofronte shënimet (të dhëna) si faturat a po kartelat financiare në lidhje me këto të arkëtueshme. Kjo ka ndodh për shkak se zyrtarët që merren me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme nuk kanë mbajtur dhe azhurnuar dosjet dhe regjistrat e llogarive të arkëtueshme si duhet.	llogarive të arkëtueshme do të azhurnojë dhe mbajnë regjistrat të saktë të llogarive të arkëtueshme.	kompetent që të merren me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme përmes azhurnimit dhe mbajtjes së regjistrave me të sakta të llogarive të arkëtueshme.	perkatëse.		
14	Çështja B6 Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Neni 26 Ligji nr.06/L-005 Për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton se Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të paguara që kalojnë shumën e 10€. Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2023, komuna ndërmori veprime	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të	Do të zhvillohen aktivitetet e nevojshme për të ulur nivelin e llogarive të arkëtueshme si synim ynë për rritjen e inkasimit të te hyrave vetanake de njëkohesisht	Zyra e Tatimit ne Pronë; Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Janar – Dhjetor 2024	

		për të mbledhur borxhet duke dërguar faturat e shfrytëzimit të pronës publike në përmbartim, llogaritë e arkëtueshme në total, krahasuar me vitin e kaluar, janë rritur nga 1,830,089€, në 1,973,138€, duke shënuar një diferencë prej 143,049€, ose rreth 7%. Rritja më e madhe është vërejtur te tatimi mbi pronën.	arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.	eliminimin e borgjeve te vjetërsuara.		
--	--	--	---	--	--	--